

Procesverbal

*Nga mbledhja e V- (pestë) e rregullt e Kuvendit Komunal në Dragash , e mbajtur më datë:
25.05.2023*

Rend Dite

- 1) Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
- 2) Propozim Vendim për miratimin e Planit Komunal për Riintegrimin e Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve në Komunën e Dragashit 2023-2025,
- 3) Propozim Vendim për shpalljen e Interesit Publik për Zonat Kadastrale , ZK Rrenc – P-706040036-00008-0, ZK Vraniç P-70604010-00896-0, ZK Vraniç P-70604010-00902-7, ZK Kapre P-70604020-00617-0, ZK Kapre P-70604020-00002-0, dhe
- 4) Eventuale.

Uran Halimi: Të nderuar delegatë, nëse jemi gati, po fillojmë më seancën e V-të të rregullt për vitin 2023 të Kuvendit Komunal në Dragash. Faleminderit për pjesëmarrjen! Siç e keni pranuar edhe në material, elektronike edhe fizike, e dini tashmë që në rend dite janë paraparë këto pika të rendit të ditës: e para ka të bëjë me miratimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar, në pikën e dytë e kemi Propozim Vendimin për miratimin e Planit Komunal për Riintegrimin e Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve në Komunën e Dragashit për vitin 2023-2025, në pikën e tretë me radhë e kemi Propozim Vendimin për shpalljen e Interesit Publik për Zonat Kadastrale, numrat i keni këtu, në fshatin Rrenc dhe Kapre, edhe pikën e katërt edhe të fundit e kemi pikën eventuale. Para se me e hedhë në votim këtë rend të ditës, deshta të ju njoftoj që kemi edhe dy propozime dje nga KPF. E kemi një propozim për shtimin e dy ngastrave kadastrale në pikën e tretë të rendit të ditës, edhe e kemi një propozim që të shpallet pompa, këtu përballë Stacionit të Autobusëve në Dragash, të shpallet...të futet si pikë e re e rendit të ditës, domethënë është fjala për pompën përballë Stacionit të Autobusëve që të shpallet zonë me interes të përgjithshëm ose me interes publik. Po, nëse do me e marrë dikush fjalën, mundet. Fjalën e ka kërkuar z.Naser Myrtezani nga LDK dhe pas tij fjalën e ka z.Nedžmidin Sejdlilar nga Pokret za Gora.

Naser Myrtezani: Faleminderit, kryesues! I nderuar kryetar i Komunës, përshëndetje për të gjithë! Atëherë, edhe na si grup parlamentar kërkojmë që të futet kjo pikë që ju e sqaruat, pikë të rendit të ditës, pra për pompën e benzinës që bëhet fjalë në hyrje të Dragashit, dhe na kërkojmë që të futet si pikë e rendit të ditë. Faleminderit!

Uran Halimi: Faleminderit, z.Myrtezani! Fjalën e ka z.Nedžmidin Sejdlilar.

Nedžmidin Sejdlilar: Të nderuar të pranishëm, e kuptoj që qeveria na jep çdo seancë diçka të tillë si nga frigoriferi, si një picë nga ushqimi i shpejtë. Kështu jeni sot këtu dhe keni dorëzuar një dokument, i cili ka më shumë se 10 faqe, 24 minuta pas fillimit të kohës së rregullt për këtë seancë. Le të më shpjegojë dikush i zgjuar se si unë si delegat mund t'i analizoj këto 10 faqe dhe të marr një vendim. Unë ju paralajmëroj çdo seancë dhe ju kërkoj me shumë mirësjellje, seancat i përgatisni ju vetë, seancat nuk ju përgatis unë. Qeveria i përgatit seancat së bashku me kryesuesin. Vendoseni materialin në kohë. Si do ta kuptojë një person normal këtë material, kur e dorëzon 24 minuta pas kohës së rregullt të seancës. Përveç nëse ka ndonjë lloj mashtrimi të përfshirë. Mendoj se kryetari i kuvendit duhet ta refuzojë këtë dokument dhe të propozojë që të shqyrtohet në një seancë tjetër.

Nuk e di fare se çfarë po bëhet në këtë pikë të rendit të ditës. Më duhet kohë për të analizuar dhe marrë parasysh këtë pikë, ndoshta ju të tjerët jeni më të zgjuar se unë, kështu që mund ta analizoni materialin me një dokument prej më shumë se 10 faqesh në dy ose tre minuta. Unë nuk mund ta bëj këtë. Kjo nuk është as dinjitoze dhe as e denjë. Ajo dëmton reputacionin tuaj, dhe mua absolutisht nuk më intereson reputacioni juaj, politikisht ju po shkoni pikërisht në drejtimin në të cilin dua t'ju shoh. Por në të njëjtën kohë, kjo dëmton edhe reputacionin Kuvendi, pjesëtar i të cilit jam edhe unë.

Uran Halimi: Faleminderit, z.Sejdilar! Dikush tjetër a do me e marrë fjalën? Fjalën e ka kërkuar z.Artan Loshaj nga PDK.

Artan Loshaj: Përshëndetje për të gjithë! I nderuar kryetar dhe ju kryesues, dje në Komitet kemi pas një propozim-vendim, dhe kryetari tha që qytetarët e fshatit Rrenc kanë qenë dhe janë ankuar, dhe me mirëkuptimin e kryetarit dhe qytetarëve janë marrë vesh që parcela me numër 706040036-00008 të largohet nga kjo dhe të ndërrohet destinacioni tjetër, ndërsa sot prapë është e njëjta parcelë në vendimin e juaj, plus edhe dy parcela tjera. A është ndonjë lëshim teknik që jeni ngut me e prur shpejt e shpejt në seancë, apo çka është puna nuk p'e di. Tjera herë vënjani mendon, bonu ma të kujdesshëm, se këta shkruan 'propozim- vendim', këtu po shkruan 'vendim'. Këtu po na detyroni edhe me votue, domethënë ky vendim veç është marrë, na veç e ngremë gishtin, se i keni gishtat, normal, athëherë mos e bini hiç. Edhe e dyta, edhe ni herë po ju thom, qet parcelë dje keni thonë që kemi me e largue. Jemi marrë vesh këtu me e largue, për hir të qytetarëve të fshatit Rrenc, ndërsa sot prapë juve ju figuron këtu, plus edhe dy i keni shtue. A pse unë e kam kundërshtue si opozitë, a çka o puna, a s'un jeni marrë vesh? A ka mundësi kryetar ni sqarim qetu, për qet parcelën? Faleminderit!

Uran Halimi: Faleminderit, z.Loshaj! Dikush tjetër a do me e marrë fjalën? Sa i përket ankesës së z.Sejdilar, ju e dini që unë çdo propozim që propozoni e kam për obligim me e hedhë në votim. Arsyet pse këtu i bien propozimet në seancë, s'mundi me e dhonë ni përgjigje në këtë drejtim, mirëpo propozimet të cilat i boni ju delegetë të nderum, unë e kam patjetër që m'i hedhë në votim. Sa i përket numrit të votave, a i kanë a s'i kanë, prapë s'jam unë përgjegjës për këtë punë. Kështu që, e kisha ftue kryetarin, unë këtë nashta s'p'e kujtoj që kemi propozue me e largue këtë parcelë. Unë e kam ni propozim që – e pata edhe të shënum – që m'u shtu vetëm dy parcela. Qeshtu e pata të shënume, e kam mbajt shënim dje, domethënë në KPF. Qe kryetari po na jep ni sqarim, se unë s'kam ide nëse kemi marrë vendim na, ose propozim për me largue këtë parcelën.

Bexhet Xheladini: I nderuar kryesues, zëvendëskryesues, të nderuar asambleistë, përfaqësues i OSBE-së, media, ju përshëndes të gjithëve! Unë – më falni që u vonova, i pata disa palë të cilët më vonuen edhe s'mujta me ardhë me kohë këtu – sa i përket pikës së rendit të ditës e cila duhet të futet si pikë e re, të cilën e propozoi Naseri, na jemi marrë vesh dje edhe në Komitet, kemi propozue edhe në Komitet ka kalue kjo, dhe është fjala për dy parcela të reja të cilat ne duhet t'i shpallim interes të përgjithshëm për ndërtimin e deponisë së mbetjeve inerte, për të cilën na si komunë kemi konkuruar në programin e BE-së, gjegjësisht Programin IPA 2 me Shqipëri. Edhe ma herët na, kur e keni marrë rendin e ditës, kemi propozue disa parcela tjera, dy a tri, a sa kanë qenë, nuk e di, dhe ndërkohë, dy qytetarë të fshatit Rrenc kanë ardhë dhe na kanë dhonë ni propozim tjetër. Komisioni jonë ka qenë në vend të ngjarjes, e ka pa atë propozim dhe kemi konstatue se propozimi i atyne dy fshatarëve ka qenë shumë ma i mrë, vendi është shumë ma i mirë dhe ma i përshtatshëm edhe ne jemi përcaktue që, do të thotë lokacioni i mundshëm të jetë ai, dhe ne këtu, ne mujm ato parcelat e mahershme që i kemi propozue mujm edhe m'i hek, nuk është problem, mujm edhe m'i lonë, m'i shpallë interes të përgjithshëm edhe me mbet si dokument, jo më për parcela po me mbet si dokument që Komunës

nëse i duhen për diçka tjetër, po mundim edhe m’i hek prej rendit të ditës, nuk është problem. Po na do të përcaktohem këtu, për këto dy parcela që i kemi propozue dje, që këto do të jenë të destinume për deponi të mbetjeve të ngurta. Gjithashtu unë, jashtë kësaj, kohëve të fundit me hyrjen në fuqi të Ligjit të pagave, kanë ndodhë disa çrregullime me pagesat për ju, asambleistë. Disa po më drejtohen mu. Ju e dini që unë nuk kam kompetenca m’u përzie në punën e Asamblesë, në pagat, në mëditjet e juaja, po njerëzit, delegatët, me nevojë ose pa nevojë, po më drejtohen edhe mu. Po më lakohet edhe emri i kryetarit ndoshta diku, ndoshta diku me qëllim, ndoshta diku pa qëllim. Unë e kam thirrë këtu zyrtarin i cili është kompetent për këtë punë. Nëse keni dikush ndonjë pyetje me ia bo, keni pakënaqësi, keni probleme me pagesat, është mirë ta shfrytëzojmë prezencën e tij këtu, kush ka, nëse...ose, masi të kryhet Asambleja, mundni me shkue drejtpërdrejt në zyrë te ai edhe me marrë informata prej tij. E di që i keni disa probleme, disa ndoshta kanë marrë ma shumë, disa kanë marrë ma pak, po kjo nuk është problem i Komunës, është problem që ende Ligji, edhe pse ka ardhë në fuqi, ende edhe ata vetë që e kanë pru s’po dijnë me interpretue. Nëse keni kësi probleme, mundni me e shfrytëzue Mujën që është këtu, me bo kësi pyetje. Faleminderit!

Uran Halimi: Faleminderit, kryetar! Sa i përket kësaj pjesës ose çështjes së pagesave, na ma herët e kemi pas ni takim me zyrtarin në fjalë, mirëpo këtë do ta diskutojmë në pikën eventuale. Faleminderit për prezencën, i nderum, po në fund të seancës këtë do ta diskutojmë, s’ka të bëjë kjo me rendin e ditës. Atëherë, replikë ka lyp ni minutë Artan Loshaj dhe pas tij z.Sejdilar.

Artan Loshaj: Zoti kryetar, në fillim e keni gabim, se dje na keni pru propozim-vendim, ndërsa sot bini vendim. S’po ju kuptoj. Ni, e dyta, dje e diskutuam shumë mirë në Komitet, ti thaje disa qytetarë të fshatit Rrenc, sot po thuosh dy qytetarë. Jo, shumica e fshatit janë të njoftuet, edhe ti ke thonë që jemi... përfaqësuesit e fshatit Rrenc kanë qenë, u krye...ama janë të njoftuet i gjithë fshati, edhe ata nuk janë konë kundër kësaj, janë për mbeturinat e ngurta, po lokacioni iu ka pengue. Edhe në bashkëpunim me ty, ti ke thonë që keni me gjet gjuhë të përbashkët, nuk ke gjet kryetar gjuhë të përbashkët, prapë qat parcelë që ke thonë dje p’e largojmë, prapë e kie këtu. Edhe tash edhe dy tjera na ke shtue kah Pllava, njo e ke shtue kah Rrenci, qytetarët e fshatit Rrenc nuk e meritojnë me na rrethue me mbeturina të ngurta. Nuk e meritojnë, kryetar. Ti qetash këtë e ke bo për inat, ti po më thuosh jam marrë vesh me ata ... a guxoj me folë, unë nuk të ndërpreva. Ti, i nderuar kryetar, dje, e kemi inçizimin – plus edhe muajin e parë s’ma keni dhonë audioinçizimin, se me fjalët e juaja bini ndesh, këtë e keni politikë bajagi të specializuet – unë po thom dje, i kie të gjithë delegatët, dje na ke thonë që kjo pikë do të largohet, kjo, do të ndërrohet destinacioni, prej Kapres do të del kah Pllava. Në rregull, po prapë e kie Kapren këtu, kryetar, s’p’e dijsh çka je t’u bo ti. Qe, e kie parcelën e njëjtë e kie, parcela është e njëjta. Kqyrni bre kolegë delegatë qaty, parcela është e njëjta, nuk e ke largue kah Kaprja. I ke qit edhe dy në Pllavë. Një në Kapre, dy në Pllavë edhe na ke rumbullaksue, na ke bo krejt mbeturina Rrencin. Do të na detyrosh me marrë azil, me dalë kah Dragashi krejt. Ti me fjalët e tua po biesh ndesh, bashkë me drejtorin. Keni qenë Komisioni, e keni pa, vendi shumë i mirë, shumë në rregull, në rregull. Nuk jemi – edhe për te Kaprja jo – rrua është e ngushtë, nëpër Rrenc nuk kalohet, se kemi ujna të zeza, kemi kanalizime, kemi kubëzime, të gjithë investimin 20 vjeçar e çojsh në zero. Ni kamion që kalon aty pari i ka 10-15 ton aty. Është krim ajo që p’e boni ju. Largone qet të Kapres, qitni dy knena, çilne udhën prej te hyrja e vjetër e Pllavës, edhe çoni mbeturinat. Nëpër fshatin Rrenc problem e keni me kalue. Faleminderit!

Uran Halimi: Faleminderit! Na kur të vjen puna te pika specifike, na mundim me diskutue edhe mandej, se shumë herë po na bjer ka dy-tri herë me diskutue për ni pikë. Ju lutem, na po flasim për

rendin e ditës, mandej kur të kalojmë te pika e tretë, na mundim me diskutue prapë edhe me marrë bon vaki edhe ni pajtim p'i kryetarit, që nëse s'prish punë edhe m'u largue kjo parcelë. Sidoqoftë, diskutojmë te pika e tretë e rendit të ditës, kur të vjen puna. Ni minutë replikë e ka kërkuar z.Sejdilar. **Nedžmidin Sejdlar:** Kryesues, këtu demokraci s'ka moti, po shnoh! Edhe ky dokument në fakt është ni shembull jo i demokracisë, po anarkisë. Qato deshta me thënë këtu në foltore, po masi kryetari nuk ka vu dëgjuese për përkthim, po e them edhe në shqip. Kryetar, ju e keni kohën sa të doni me përgatit seancën. Ju si pushtet, kryesuesi si kryesues i Kuvendit, sa të doni e keni kohën me përgatit seancën, që do të thotë, kur na bini materialin në zarf, mo mos na shtini si pica prej frigoriferit. Qe, ju na prut sot dhjetë faqe ma shumë dokument. Qat dokument unë për ta votuar duhet me hulumtu. Unë momentalisht nuk kam vakt me bo atë. Këtu në Kuvend shumica jeni mësuesa, qetash, për shembull qe drejtori – urime, drejtor! – a mundesh ti me e pyet nxanësin rreth lëndës që ia ke pru në atë orë? Qysh t'i paraqitem unë karshi qytetarit këtu s'e di, qat hall e kam. Ju ma keni pru dokumentin me vonesë, 24 minuta pas kohës së rregullt të seancës. A mundeni me më shpjegu unë qysh të debatoj rreth këtij dokumentit? Qat hall e kam, kryetar. Unë e di që ju jeni kundër demokracisë, doni anarkinë me e bo këtu edhe qysh të thoni ju, qashtu të vendosim. Po bile pak qajo demokracia vizuale le të respektohet.

Samidin Xheladini: Përshëndetje, të pranishëm! Unë – po më vjen keq – se na jemi këtu për çka ka nevojë, çka të ka nevojë duhet me debatue. Në qoftë se ka nevojë, dy ditë, tri. Vetë Nedžmidin Sejdlari ka thonë, në qoftë se ka nevojë rrimë 24 orë, 48 orë, ni javë ditë rrimë në seancë edhe i debatojmë fjalët. A ke thonë vetë, Nedžmidin? A ke thonë dje në Komitet për Politikë e Financa që banorët e Dragashit kanë marrë peticion, e ke sulmue personin zyrtar, pse s'ka ardhë kërkesa dje e sot e. Nedžmidin, bone pak...more dy replika boni...ej, ti je këtu për kërkesat e qytetarëve. Kurrëfarë interesi s'kemi, çka po doni me thonë? Në qoftë se është interes i përgjithshëm i popullit, u krye muhabeti. Secili ka te drejtën e vet me votue. Mos na hupni kohën neve pa nevojë me gjona pa lidhje, se s'kemi kohë na, kemi punë shumë ma me rëndësi me bo, e jo – më fal në shprehje – bagla e lopës, bagla e kalit.

Nedžmidin Sejdlar: I nderum z.Xheladini, edhe kjo paraqitja e jote këtu u konë nifarë demonstrimi i forcës. Qashtu unë e kam marrë vesh. Na këtu jemi për të mirën e qytetarit, debatojmë jo ni javë, debatojmë edhe ni vjet në qoftë se ka nevojë, po asnjoni këtu – ju lutem, z.Xheladini, më ngoni pak, në qoftë se ka nevojë, se ju ketë në foltore, unë ju ngova. I nderum kryesues, a bon veç pak rend, jo, pak rendin me bo, i nderum kryesues, si të bon, këtu në seancë, në qoftë se nuk prish punë. I nderum z.Xheladini, na jemi këtu për me shqyrtu kërkesat e qytetarit, me debatue edhe ni vjet në qoftë se ka nevojë, po asnjoni prej nesh nuk mundet m'i dhonë urdhër tjetrit, qysh e bëtë ju këtu, në këtë foltore. Ju mundeni këtu me debatue, po mu me më dhonë urdhëra çka bëj unë, unë e kam partinë teme, unë e kam politikën teme, unë kam votues të mi, ata ja më shpërblejnë ja më dënojnë. Edhe ju lutem mos i boni qeto gjëra mo, më respekto. Po ju respektoj edhe si njeri edhe si delegat. Mujm me dabatu, po urdhëra me dhonë, ajo është ni shembull i diktaturës që ju si pushtet aktual doni me instalu në këtë komunë. Qashtu edhe po silleni. Rreth qatij peticionit, i nderum koleg Xheladini, p'i kësaj komunës, informata të ndijshme private kanë dalë, edhe janë thirrë njerëz në telefon për m'u kërcënu pse e kanë nënshkru peticionin. Kjo është pamja e pushtetit aktual.

Uran Halimi: Faleminderit, z.Sejdilar! Mirë është m'u respektue secili, faleminderit për respektin që e tregoni shpeshherë për kolegët e juaj. Është mirë me i përmbyllë këto diskutime, sidomos kur po dilni në personale, s'po më pëlqen hiç. Po diskutojmë për rendin e ditës, ma mirë është me thonë

diçka të mirë, se me folë shumë e mos me thonë kurgjo. E kemi rendin e ditës, i kemi propozimet, i kemi edhe duart për me votue, veç që hargjojmë kohë kot. Po vazhdojmë me rendin e ditës, i patëm propozimet që unë i thashë, edhe p'e hedhim në votim këtë propozimin e z.Myrtezani që e boni në lidhje me – se kryetari pak ma herët gaboi aty, se kryetar, propozimin z.Myrtezani e boni në lidhje me futjen në rend të ditës të kësaj pompës përballë stacionit, ndërsa pjesa e parcelave ka qenë dje e Komitetit. Po, sidoqoftë, ta kemi me dije që propozimi i z.Naser Myrtezani ka të bëjë me futjen e një pike të rendit të ditës, ku është fjala për shpalljen e interesit publik të popmës së Dragashit, e cila gjendet përballë Stacionit të Autobusëve. Kush është pro këtij propozimi që të futet si pikë e veçantë e rendit të ditës në këtë seancë. Kush është pro këtij propozimi? Kush është kundër këtij propozimi? Abstenim? Atëherë, konstatoj që me 14 vota pro, me 7 kundër edhe me dy abstenim, kalon propozimi i z.Myrtezani. Në rregull, po më thonë që është në rregull. Atëherë, Atëherë e hedhim në votim edhe rendin e ditës, me propozim-ndryshimin e z.Myrtezani edhe të drejtorit...në rregull, atëherë e kemi veç me propozim-ndryshimin e z.Myrtezani, ndërsa sa i përket propozimit të z.Kolloni, dje që është bërë në KPF, mundim me e diskutue kur të arrijmë te pika e rendit të ditës, domethënë te pika numër tre. Kush është pro këtij rendi të ditës? Kush është kundër këtij rendi të ditës? Abstenim? I kemi 16 vota pro, 6 vota kundër edhe zero abstenim. Vazhdojmë me pikën e parë të rendit të ditës, e kemi miratimin e procesverbaleve nga mbledhja e kaluar. Nëse ka dikush me diskutue në lidhje me procesverbalet, ndonjë vërejtje ose ndonjë lëshim të mundshëm, mundni me e marrë fjalën.

Nedžmidin Sejdlar: Zoti Kryetar, kjo nuk ka lidhje me procesverbalin. Dua t'ju kujtoj vetëm se më keni diskriminuar dhe nuk e hodhët në votim propozimin tim. Z. Jonuzi, ju kërktoj që si person që duhet të mbrojë të drejtat e mia këtu, sepse ju jeni nënkryetar i Kuvendit nga radhët e komunitetit joshumicë, të kontaktoni organet kompetente dhe të shikoni nëse ky vendim është ligjërisht i saktë.

Uran Halimi: Faleminderit, z.Sejdlar! Ju lutem përmbajuni pikave të rendit të ditës kur të folni, ose kur ta merrni fjalën. Ke fjala për pikën e parë të rendit të ditës, miratimi i procesverbaleve. Unë thashë që nëse keni nevojë me shtu diçka në lidhje me procesverbalet. Ke mund me e marrë fjalën pak ma herët, kur është votue rendi i ditës. Munir, nëse duesh me e marrë fjalën në lidhje me procesverbalin, mundish me marrë fjalën, jemi t'u diskutue për procesverbalin. Sa i përket replikave tjera, mundish m'i bo në eventuale. Atëherë p'e hedhim në votim, meqenëse s'ka diçka....në lidhje me procesverbalin? Okej, Artan Loshaj e ka fjalën.

Artan Loshaj: Zotni kryesues, edhe në Komitet dje kemi diskutue, unë nuk pajtohem me këtë procesverbal të KPF-së. E dish pse, sepse e ke shkelë ni të drejtë elementare të qytetarëve, sidomos temen si asambleist. Ta kam bo ni shkresë zyrtare që audioinçizimin me ma dërgue, ose në CD ose në USB, nuk ma keni dhonë. Më keni kthye ni përgjigje, me prit deri sa të del procesverbali. Ka dalë procesverbali, unë prapë nuk jam i kënaqet me këtë, se unë kam folë ma tepër se që duhet. Edhe ju prapë po heshtni, edhe dje s'kam marrë përgjigje, kam qef edhe sot para delegatëve me marrë përgjigje, sepse e keni shkelë ligjin me të dy këmbët, për qasje në dokumentet publike, pikërisht nenin 3, pika 1.2, ku thuhet dokument publik çka është, 'nënkupton çdo akt, fakt apo informatë, në formë elektronike apo me zë, në formë të shtypur, në incizime vizuale, të prodhuara apo të mbajtura nga institucioni publik.' Ti këtë të drejtë ia ke marrë ni delegati të Kuvendit Komunal që e përfaqëson qytetarin. Çka boni ju edhe pushteti ni qytetar i thjeshtë me ardhë me lyp ni informatë nga ju? E keni shkelë, prapë po ju thom, ligjin. Ju lutem, ma konfirmoni, ma jepni përgjigjen se përndryshe, e dini shumë mirë, mos e merrni si kërcënim, unë e kam përgatit lëndën, do t'ju padis edhe me avokat, do t'ju padis edhe te Avokati i Popullit. Faleminderit!

Uran Halimi: Shumë faleminderit! Për të gjithë opinionin publik, delegati në fjalë përgjigjen zyrtare e ka marrë, qasje në dokumenta zyrtare – po flasim për procesverbalin që ju e merrni secili – çfarë qasje me pas, kur na ju bina edhe pa kërkuar atë? Procesverbalin, çkado që na themi këtu, e keni secili. E lypet s’e lypet, atë e merrni ju. Edhe personi në fjalë e ka marrë procesverbalin, në përgjigje, siç e di i nderumi, ka marrë përgjigje që nëse ka ndonjë vërejtje, ka thonë ma shumë se që është shkruar në procesverbal, ka të drejtë me dëgjue audioinçizimin e seancës. Dokumentin zyrtar e merr, Artan, e ke marrë dokumentin zyrtar. Kështu që, sa i përket pjesës tjetër për ankesë edhe padi, s’është problem. Jemi njerëz, mundim edhe me gabue, për me padit na jemi të lirë, kushdo, secili. Nëse menojsh se t’u shkelë e drejta, ankohu edhe më padit, s’është problem, unë këtu jam. Kem t’u folë për procesverbalin e mbledhjeve të kalume, po folim për procesverbale të komiteteve. Fjalën e ka kërkuar z.Jonuzi, pastaj ni minutë replikë e ka z.Artan Loshaj, meqenëse e përmenda.

Munir Jonuzi: Të nderuar të pranishëm, edhe pse fjalimi im nuk ka të bëjë me pikën e rendit të ditës, kolegu Nedzmidin theksoi pozicionin tim, prandaj ju lutemi ta konsideroni atë si dhe pozicionin tuaj. Ju keni një të drejtë të pakufizuar për t’iu përgjigjur çdo pyetjeje të këtyre delegatëve, dhe unë kam të njëjtën të drejtë kur bëhet fjalë për komunitetin jo-shumicë. A janë shkelur të drejtat e zotit Nedzmidin këtu, mendoj se janë shkelur. Zoti Nedzmidin si përfaqësues i subjektit politik nga Gora ka të drejtë të propozojë, ju vendosni nëse do ta votoni atë propozim. Megjithatë, kjo është diçka për të cilën duhet të flasim, unë dhe ti. Ky propozim, me sa kuptova, ishte shtyrja e vendimit për shpronësimin e parcelës kadastrale me interes publik pranë stacionit të autobusëve. Unë personalisht jam kundër shtyerjes. Unë duhet të them atë. Por dua të respektoj të drejtën e kolegut Nedzmidin për ta hedhur në votim. Nëse kemi një propozim delegati, atëherë duhet ta respektojmë. Dhe kjo nuk mund të presë përfundimisht pikën, sepse pika përfundimisht nënkupton që delegatët, anëtarë të këtij kuvendi, të pyesin pushtetin ekzekutiv për problemet në komunën tonë. Kjo është arsyeja pse kjo pyetje po bëhet tani.

Uran Halimi: Realisht po çuditëm shpeshherë, shumë singërisht po çuditëm! Kur ni propozim bohet, si për shembull, e kemi propozimin e z.Myrtezani për m’u fut në rend të ditës, edhe e kemi ni propozim për m’u hek p’i rendit të ditës. U fut në rend të ditës me 14 vota pro ose me ma shumë vota, e çka me votue mo, o Nedzmidin? A po kuptojsh? Mos e merrni bre fjalën me thonë kurgjo, mu qekjo po më shqetëson o vëllla, thoni diçka kur ta merrni fjalën. U fut në rend të ditës me shumicë të votave, s’hiqet mo me shumicë të votave. Kem t’u folë për procesverbale bre, ju lutem ej. A ka diçka vërejtje, e pat ni minutë replikë Artani, nëse do me e marrë fjalën.

Artan Loshaj: Zotni kryesues, na jemi shumë të vetëdijshëm që procesverbalet vijnë. Po unë po të thom, se ti e di që nuk e din, se nuk je edhe jurist, po ti e dëgjoish Ademin që e kie në krahin e majtë, që është krahi i majtë i yti dhe krahi i djathtë i ...

Uran Halimi: O Artan, mos i personalizoni bre gjërat! Ti më thaje çka kie me më thonë, m’ke thonë edhe në Komitet. Përgjigjen ta kam dhonë unë, s’kam çka të jap ma shumë se qekaq. A po kupton? A e ngoj a s’e ngoj, s’ka lidhje, ti m’ke kallxue çka kie me ndërmarrë, unë p’e pres atë që ti p’e ndërmarrish, çka me bo diçka, veç si të doni diskutojmë hala, folim për këtë çështje.

Artan Loshaj: Unë po due pak me të kthjellë ty, se Ademin që e kie, zyrtarin ligjor në krahin e majtë, e kie edhe krahi të djathtë të kryetarit. Unë po të thom ligjin p’e shkelish, konsultohu pak. Inatet ju që keni personale ndaj meje si opozitë, mos i reflektoni këtu mor burra. Është qeky ligji i Republikës së Kosovës, qat shtet që e udhëheq Albin yt. Qeky është, qeto e ke shkelë ligjin ti. Konsultohu mor burrë, kie edhe jurista tjerë. Çdo dokument publik duhet edhe me audioinçizim me

m'i dhonë, o kryetar, o kryesues. Na kemi kërkuar këtu që me pas edhe kamera, po seancën tjetër me qenë Radio Sharri prezent, do ta ndaloni atë me inçizue? Mos o kryesues, gabim je o kryesues. Mos e ngoni Ademin, se qeky Ademi Partinë Demokratike e ka çue në opozitë, ju çon edhe juve. Qe ku e keni edhe këtë, kryetari ia kam kallxue edhe dje, që e keni akuzue për vjedhje, për sende...

Uran Halimi: Zyra e Kuvendit nuk është çështje e diskutimit këtu. Po nuk e vendosim na o, na jemi Kuvendi këtu, nuk jemi ekzekutivi, na nuk punësojmë Adema, as nuk largojmë prej punës...

Artan Loshaj: Është, pse s'është? Po Zyra e Kuvendit e ka bo kryesues këtë. Jo, ju i punësoni këta Adema, se në Zyre të Kuvendit bohen këto sende, këto lojna. Se ju këtu e keni shkruar 'shihemi në gjyq, fundi i hajdutnisë'. Nuk është fundi hajdutnisë, është fillimi i hajdutnisë me Ademin.LDK

Uran Halimi: Ni minutë replikë z.Jonuzi.

Munir Jonuzi: Është e qartë për mua që njëra përjashton tjetrën. Nëse propozimi i Naserit kalon, ai automatikisht nuk kalon propozimin e Nedzmidin. Mirëpo, ju jeni të detyruar t'i shpjegoni zotit Nedzmidin dhe t'i thoni këto fjalë: Zoti Nedzmidin, propozimi i zotit Naser ka kaluar dhe nuk ka kuptim që unë ta hedh në votim propozimin tuaj. Gjithçka është në rregull këtu, përveçse duhet ta kishit ndjekur atë sugjerim. E para e përjashton të dytën. Nëse e kalon propozimin e Naserit, nuk e kalon propozimin e Nedzmidin. Thjesht duhej t'i shpjegonit atij.

Uran Halimi: Miratimi i procesverbaleve, këshilla për mbarëvajtje të seancës, edhe ankesa të ndryshme. Kush është pro pikës së parë të rendit të ditës? Kush është kundës kësaj pike të rendit të ditës? Abstenim? Faleminderit për votimin! I kemi 22 vota pron 1 kundër edhe zero abstenim, kalon pika e parë e rendit të ditës. Te pika e dytë me radhë e kemi propozim-vendimin për miratimin e Planit Komunal për Riintegrim të qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrim të huajve në Komunën e Dragashit për vitin 2023-2025. Nëse keni ndonjë vërjetje, Planin veç e keni marrë në material, mundni me e marrë fjalën përpara se ta hedhim në votim. Nëse ka veç pyetje, Fita munden me dalë me u përgjigj, përndryshe Planin e keni në material. Nëse jo, atëherë e hedhim në votim, kush është pro pikës së dytë të rendit të ditës? Kush është kundër? Abstenim? Faleminderit! I kemi 23 vota pro, zero kundër edhe zero abstenim, kalon edhe pika e dytë e rendit të ditës. Po shkojmë te pika e famshme me qujt, e kemi propozimin e z.Qamil Kolloni që në këtë pikë të futen dy parcela më shumë. Artani diskutoi edhe tha që ni parcelë me hek, me kërkesë që sipas tij e kanë bo banorët e Rrencit. Unë nuk e kam pranue ndonjë kërkesë me shkrim si kryesues, ose qysh po thotë delegati në fjalë, si rregullues i rendit të ditës. Kështu që, nëse do dikush me e marrë fjalën.

Qamil Kolloni: Përhëndetje kryetar, përhëndetje kryesues, zëvendëskryesues dhe ju delegatë! Krejt ky plottësim-vendimi është me qëllimin ma të mirë të mundshëm. Parcelat të cilat i kemi parapa, të parat, për me bo deponinë për mbetje inerte, ka qenë në Planin Zhvillimor Komunal. Bashkarisht me zyrtarin për planifikim hapësinor dhe me inspektorët i kemi vizitue të gjitha pikat. Çka ndodh këtu, këtë propozim të cilin e kanë pru qytetarët e fshatit Rrenc, ka dalë me të vërtetë një propozim shumë i mirë. Mirëpo këto parcelat na nuk i kemi hek, me motivacionin se ato parcela janë të pylltarisë. Në këtë rast, në qoftë se i shpallim zonë me interes të përgjithshëm, na kthehen neve si komunë dhe shumë ma lehtë qytetarët e Rrencit kanë mundësi që, po që se ka nevojë për interes të tyne, t'iu jipen prej komunës në shfrytëzim. Në qoftë se ata insistojnë që të mos veprojnë me këtë logjikë dhe ta marrin si çështje politike, veç me shty, na mund t'i hekim në këtë moment. Pse janë dy parcela?! Të dy parcelat janë në të njëjtin vend, mirëpo për shkak të llojit të kultivimit, se është pyll edhe shkurrë, janë dy parcela, i njëjti vend është, në të njëjtin vend janë dy parcela, qaty ka m'u ndërtue. Edhe këto parcelat tjera, të cilat janë dy në Rrenc, dy në Kapre, po të njëjtin vend janë, edhe

në Kapre parcelat janë në po të njëjtin vend, mirëpo për shkak se janë mal edhe është pjesë e zhveshur, ndahen në pylltari në dy parcela dhe për këtë arsye doket se është numër i madh i parcelave. Në fakt, nuk është numër i madh i parcelave, janë të njëjtat parcela në të njëjtin vend, veç kjo ndryshon. Unë që jam marrë deri më tash, ju lus si delegatë të keni mirëkuptim, se kurgjo në dëm të qytetarëve të Rrencit nuk shkon, po as të komunës jo. Në asnjë mënyrë. Tash na mund ta politizojmë, mund të flasim çka të doni, e drejtë e juaja. Unë ju propozoj kështu, në qoftë se doni me e hek edhe insistoni me e hek, unë po due me pas mirëkuptimin e juaj, se është interesi i Komunës, është ni projekt shumë i mirë, edhe që të kemi një mirëkuptim mor burrë i dheut, se nuk politizohen gjërat të cilat shkojnë në interes të gjithëve. Për këtë arsye unë propozoj që ky plotësim-vendimi të shkojë me këto dy parcela edhe parcelat të cilat janë ekzistuese. Në qoftë se doni ju, na p'i hekim ato parcelat, nuk ...po s'kemi interes që me ia bo, mos me lonë njerëzit me politizue pa nevojë, e hekim edhe u krye muhabeti, se s'na pengon kurgjo ajo.

Uran Halimi: Drejtor, faleminderit për fjalën! Dikush tjetër nëse do me e marrë fjalën? Kryetari e ka kërkuar fjalën edhe pas tij fjalën e ka z.Munir Jonuzi.

Bexhet Xheladini: Unë propozoj që ato parcelat të cilat kanë qenë ma herët të propozume të hiqen, sepse kur të shpallen interes i përgjithshëm, atëherë duhet edhe me arsyetue pse po shpallet interes i përgjithshëm. Na tash interesin e përgjithshëm edhe arsyetimin e kemi te këto parcelat e herës dytë, po, të fundit. Për ato tjerat arsyetimi po hiqet faktikisht, s'janë mo për deponi të ngurta, faktikisht, nëse na duhet ndonjëherë, e marrim ni vendim tjetër, kështu që ato le të hiqen, le të votohet për këto dy parcelat e reja si interes i përgjithshëm edhe le të destinohen për mbeturina inerte, do të thotë dy parcelat e fundit. Qekaq.

Uran Halimi: Shumë faleminderit, kryetar! Ide e qëllume është edhe kj, po besoj që është e ... a po duesh me e marrë fjalën? Fjalën e ka Jonuzi, pastaj e ki fjalën ti, z.Shpetim.

Munir Jonuzi: Te nderuar delegat, nëse bëhet fjalë për të njëjtën parcelë vetëm në një vend tjetër, nuk shoh problem aty dhe nuk e kuptoj pse do të votonin për ndryshim. Banorët e kësaj komune do të vlerësojnë se në bashkëpunim me qytetarët ku është vendi më i mirë për deponimin e materialeve të ndërtimit. Nëse është në të djathtë, është fushë dhe është më pak e pershtateshme, kjo është mirë për mua. Kjo është një nismë e mirë për të deklaruar interesin publik për depozitimin e mbetjeve të ndërtimit dhe sigurisht që do të mbështes nisma të tilla. Shpresoj që qeveria të mos ndalet me nisma të tilla dhe në gjetjen e më shumë lokacioneve që do të përdoren për depozitimin e mbetjeve ndërtimore. Të mos qëndrojmë vetëm në këto lokacione, sepse kemi vetëm 3 lokacione në të gjithë territorin. Komuna jonë është një nga komunat më të mëdha për nga territori, e shtata për nga territori dhe mendoj se është mirë të gjejmë më shumë lokacione që do të shërbejnë për depozitimin e mbetjeve ndërtimore. Tashmë kemi një lokacion në Vranishte, dhe më pas qytetarët nga Rapça, Brodi dhe Restelica do të transportojnë mbeturinat ndërtimore në Vranisht, që është shumë larg. Në të ardhmen duhet të punohet për gjetjen e rrugëve më të shkurtra për çdo fshat. Nga kjo do të përfitojnë më shumë qytetarët.

Shpetim Hajredini: I nderuar kryetar, faleminderit i nderuar kryesues, përshëndetje të nderuar kolegë asambleistë, OSBE, nënkryetar, të nderuar qytetarë të Dragashit, ju përshëndes të gjithëve! E humbëm ja ni orë kohë t'u diskutue për qet pikë të rendit të ditës dhe në fund tash prapë p'e diskutojmë këtë pikë të rendit të ditës. Ajo që po më shqetëson shumë mu është që, pothuajse në secilën seancë, mos të them 100% në të gjitha seancat, po na vjen nga ni material, po na përgatitet para fillimit të seancës. Nuk është bre në rregull, kryetar. Ki kujdes, po më vjen shumë keq, a janë

këta njerëz që kanë punue ma herët, a kanë njohuri në këtë drejtim, pse p'i bojnë këto lëshime dhe pse po biesh në lajthitje të tyne. Gjithmonë na po duhet me diskutue, me të qit poshtë ty për atë që p'e lëshojnë ata që janë kompetentë për këtë punë. Unë e di që ti nuk i bën këto përgatitje dhe janë njerëz të tjerë që i bëjnë këto përgatitje, mirëpo gjithë barra bie mbi ty. Prandaj është mirë që në seancat e ardhshme të keni kujdes o burrë, mos na bini, e sidomos p'i ndryshoni. Propozim-vendimi më ka ardhë mu, e kam të marrët material, tash e keni pru vendim. Nuk është në rregull, vendimi merret këtu në Asamble, ne e votojmë pastaj është vendim. Pa marrë na, pa votue këtu nuk është vendim. Nuk jam tip, e keni vërejt edhe ju qe ni vit e gjys, nuk kam dëshirë as me të qit poshtë, as me folë fjalë banale e të tilla që nuk jeni të zot për këtë detyrë, mirëpo po detyrohem qe ta marr fjalën dhe më e mira është që ajo që unë kur e diskutoj, besoj që duhet ta merrni ju për të mirë. Prandaj, ju gjithashtu gjatë diskutimit, ju thatë që do ta largoni ni parcelë të cilën e kërkoi Artani që momentalisht nuk është këtu, nuk e di ku shkoi, mirëpo edhe në vendim të njëjtën parcelë e keni. Atëherë duhet të largohet komplet tek vendimi, tek materiali i prum tash në seancë, dhe ky kur të votohet duhet të votohet pa këtë parcelë. Jo jo, në rregull është, mirëpo kryetari e largoi, me sa kuptova, këtë parcelë që figuron në të dyjat materiale. Dhe i gjithë debati nga Artani u bo për këtë parcelë. Nëse e ka largue, atëherë ne duhet ta votojmë si të larguar në këtë material të ri. A po kupton? Se s'kemi të bëjmë mo tash me këtë materialin e prum, do të thotë në materialin që na ka ardhë para dhjetë dite a kur na ka ardhë. Do të thotë me propozim-vendim nuk kemi të bëjmë, kemi të bëjmë vetëm me vendim dhe në këtë vendim duhet të largohet kjo parcelë që ne ta votojmë. Kur ta votojmë, duhet ta sqarojsh se është pa këtë vendim, domethënë pa këtë parcelë, edhe atëherë të shohim. Mirëpo, në seancat e ardhshme unë personalisht, po besoj që do ta kem mbështetjen edhe të grupit, nëse na vijnë kësi materiale të përgatitura pesë minuta para seancës, unë nuk i mbështes mo, qofshin për të mirë apo për të keq të qytetarëve, unë nuk i mbështes. Kështu që, është mirë ...okej, në rregull është, atë që e kam votue normal, prej tash nuk i mbështes. Deri më tani, e dini mirë, ju kam mbështet gjithmonë, mirëpo tash e tutje jo. Keni kujdes, na bini materialin me kohë, e lexojmë, e shtjellojmë, atëherë do të na keni krahe, do t'ju mbështesim si ju kemi mbështet deri më tani. Ju faleminderit!

Uran Halimi: Faleminderit, z.Hajredini! Sa i përket vendimit, na vendimin mundim me e shënue sa të duesh, mirëpo vendimi është i fuqishëm ose i plotfuqishëm në momentin kur unë e nënshkruj. Edhe unë s'po besoj që e nënshkruj pa ato plotësim-ndryshimet. Sidoqoftë, e mbështes këtë idenë e z.Hajredini, se realisht, ka raste kur ka urgjenca – delegatë të nderum – ka raste kur ka urgjenca edhe fusim propozime Ad hoc, qysh edhe p'e bojmë, mirëpo vazhdimisht, gati në secilën seancë na e kemi ka ni pikë. S'janë me urgjencë këto, s'e di pse mos me shty për ni seancë të radhës. Propozim i pompës, për shembull, a po kuptojsh, kur s'ka diçka me urgjencë, e lus edhe ekzekutivin me na kursye prej këtyre debateve, se veç po e zgjasim kohën edhe po ia hupim vlerën edhe seancës. Mos e nxirni edhe kryesuesin në pozitë të palakmueshme, se qetash ka raste kur unë po jam mes dy teheve. E propozove, e qite në votim, s'e qite në votim. A po kupton? Unë patjetër kam me e qit në votim, po s'është faji jem pse e qita në votim ose pse s'e qita në votim. Mos të bëjmë propozime që na nxjerrin keq edhe na ngjallin debate të panevojshme, kur kemi seanca të radhës. Hajt të është diçka me urgjencë edhe e fusim, okej, ama çdo seancë sinqerisht e kemi ka ni propozim-vendim, ka ni pikë të re, propozim-ndryshim. Kështu që është mirë me u konsultue edhe me u përgatit përpara kohës, edhe për propozimet e juve, të nderum delegatë, është mirë me bo propozime me vlerë. Sidoqoftë, po vazhdojmë. Fjalën e kërkoi z.Xheladini.

Samidin Xheladini: Për të njëjtat çështje përherë. Nuk është mirë. Mo ni herë folet, hajt dy. Përherë

të njëjtat çështje bre, të njëjtin problem. Na kemi pas me mijëra raste që ekzekutivi ose qeveria e ka për detyrë, për të mirën e qytetarëve me i sjellë para Kuvendit propozimet e veta. A e votojmë, a s'e votojmë, na jemi të pavarur, na s'kemi lidhje me qeverinë. Na këtu vendosim me shumicë votash, secili vendos domethënë qysh e sheh të arsyeshme. Edhe disa gjona meniherë po analizohen, kur po anohet kah do interesa, po analizohet meniherë sot, po bon me e pru vendimin brenda natës, m'u bo peticioni, nesër me e pru këtu, e çka ka aty s'e dijmë as na hiç, edhe duhet – s'kam përmend emër – edhe duhet na, për shembull, me e pru propozim-vendimin me e shqyrtue edhe me bo debate të ashpëra, me shqyrtue pa e dijtë çka ka në to. Ndërsa propozim-vendimet që na vijnë konform ligjeve, na duhet me bo domethënë shantazhim, m'i ...ej, na e kemi për detyrë për të mirën, kurgjo interes këtu s'ka kërkush, as personal, as...këtu është vendim domethënë që është në të mirën e qytetarëve. Qato deponitë e krejt janë në të mirën e qytetarëve. Në qoftë se e shohim të arsyeshme që është mirë edhe destinacioni edhe vendi, e bojmë, në qoftë se s'është...Edhe vendime kemi pas, krejt këta delegatët e vjetër e dijnë shumë mirë që unë e kam përkrah, asnjëherë s'e kam kundërshtue. Asnjëherë. Propozim-vendimet që na vijshin, i kam analizue aty për aty, edhe e kam pa kur janë konë edhe asnjëherë s'i kam kundërshtue, pse, se kanë qenë për të mirë, edhe kam votue. Drejt po ju kallxoj, kam votue se janë konë propozime, sikur sot që po na vinë, qashtu të bazume.

Nedžmidin Sejđilar: Kur një njeri nuk dëshiron të flasë, ju e provokoni atë. E di qe jeni jo te dishem, kjo qeveri ketu rezulton se është praktikant i amaterave. Ju nuk jeni as amatorë. Pra, praktikant i amaterave. Duke qenë se e di punën që bëj dhe e di ku dhe çfarë propozohet, ku merren vendime, ku bëhen kritika dhe ku bëhen pyetje. Në fillim e ke dorëzuar këtë dokument në një mënyrë krejtësisht të vrazhdë dhe ofenduese që nuk e hapa për hirë të pricipitë. Unë thashë që kjo pikë të shtyhet, kjo që po ndodh këtu është se as kryetari i Kuvendit dhe as ju si qeveri nuk keni mirëkuptim. Ju thjesht e injoruat atë. E drejta ime si politikan është të të lë të gaboni, dhe qëllimisht të lë të votoni të gjitha propozimet përveç këtij. Të shoh popullin, të shoh goranët e mi që u sollën në pushtet. Dhe të mos bëjnë më atë gabim. z. Xheladini unë në K.Komunitete nuk bëra presion, vetem nël menyrë informative pyta a ju ka mbritur Peticioni. Do të presim procesverbalet, do t'i lexojmë dhe pastaj do të flasim. Nuk kisha ndërmend ta diskutoja sot. Ky është një problem serioz për mua. Banorët e Dragasit e nënshkruan peticionin, e dorëzuan në zyrën e pritjes, ia drejtuan kryetarit të komunës, Komitetit për Komunitete, Kuvendit dhe tani i takon organeve që ta zgjidhin. I thashë kryesuesit të K.Komitetit të paligjëshëm se ka një peticion. Nuk kam bërë asnjë presion. Këtu, presioni është vetëm mbi mua. Sepse nuk e njehni punën, nuk ke respekt. Dhe tani nuk mund të dëgjoni deri në fund. E di që fjalët e mia ju ofendojnë, sepse nuk dini çfarë të bëni. Jo se jam shume i zgjuar, ju te gjithë ketu jeni shume me te arsimuar se une dhe e lejoni veten te provokoheni nga une me fjalimin tim, pse pse, se jeni amater të praktikanteve. Më diskriminove sot. Lërimi njerëzit e mi të shohin se si silleni. Kur do t'ju sjellim në pushtet herën tjetër, kurrë.

Artan Loshaj: Të nderuar delegatë edhe i nderuar kryetar! Unë për të dytën herë po dal. Mu po më vjen çudi, se seriozisht dje keni thonë që parcelën e parë jemi marrë vesh me e largue, në kompenzim të kësaj me e ndërrue destinacionin, me dalë nga ana e Pllavës. Arijetën, po due me e bo ni debat të vogël me to, se dje ka qenë edhe në Komitet edhe vjen prej fshatit Rrenc. Qytetarët, prapë po ju thom, nuk janë kundër. Në qet parcelë ku po doni ju me e lonë, veç me inate politike, nuk bon, nuk bon. Ata nuk janë kundër, po duhet me dalë te Pllava, ju prapë e keni lonë kryetar. S'e ka... kur e kanë hek bre? Ani s'kesh unë këtu, në rregull. A e keni hek? Kërkoj falje, më kallxo ti, mos më lë me gabue, se s'kesh këtu. Si ta ka hek, në rregull është. Faleminderit shumë! Kërkoj falje!

Arijeta Qafleshi Skeraj: Përshëndetje kryetar, përshëndetje për të gjithë! Unë nuk deshta hiç me e marrë fjalën, pasi e dëgjova kryetarin edhe drejtorin me vëmendje, që ato parcelat m'u hek. Parcela që ishte e paraparë ma herët, edhe kryetari edhe drejtori tha që, në qoftë se doni e hekim, edhe me atë mundim me votue. Për atë edhe nuk dola në fotlore, edhe unë jam kundër asaj parcelës, për arsye se banorët e fshatit Rrenc e kanë pas edhe ni takim me kryetarin, edhe kryetari në bashkëpunim me ta e ka ndërrue parcelën, edhe ata janë në dijeni që do të bëhet ndryshimi. Edhe unë jam për atë ndryshim, edhe unë nuk do ta votojsha, në qoftë se nuk do të hiqej kjo parcelë prej asaj, po pasi drejtori edhe kryetari e sqaroi mirë, atëherë do ta votoj. Deshta m'u lidhë edhe pak te propozim-vendimet. Unë, sa e dini, jam asambleistja ma e vjetër këtu, gjithmonë kanë ardhë propozim-vendimet pesë minuta përpara, na kanë thirrë jashtë, na kanë thirrë brenda, na kanë lyp ka pesë minuta me dalë, gjithmonë Kuvendi propozim-vendimet i bjer pesë minuta përpara. Kështu që, çfarëdo vendimi ju që të keni marrë, po kur të vjen propozim-vendimi për të mirë të qytetarit, është mirë me e votue. Unë shumë herë kam dalë edhe kundër partisë teme, për hatër të qytetarit. Faleminderit!

Agron Gashi: Më lejoni së pari të ju përshëndes, të pranishëm! Përshëndetje kryetar për juve, kryesues! Unë veç desha pak të lidhem me ato paraprake që ishte se disa vendime që trokitën, që erdhën tani, e kërkojnë mirëkuptimin e të drejtës ligjore apo demokratike, nuk është demokratike, sepse broshura dhe materiali përmban ni... bukur fletushka të cilat vërtet lypin ni analizë të mirëfillët, për të lexuar edhe për të ardhur në përfundim se çka konkretisht, ia vlen apo s'ia vlen. Por sido që...asambleistët, të paktën derisa e çojnë dorën dhe dalin me propozime, të kenë informacion të mriëfillët, të duhur për të. Ni, ndërsa në pikën tjetër, unë do të lidhem nga e kaluara, me deponinë ekzistuese për materiale tjera jo të ngurta, që ekziston në trokan. Është një deponi që ka vite, mund të thuash 15 vite është funksionale, por në kuptimin tjetër, sa është funksional? Është lehtë ne të japim vend-lokacione të ndryshme, t'i bëjmë legale deponi për materiale të ngurta, mirëpo sa jemi të përgatitur si komunë? Sa jemi të përgatitur si inspektorat komunal? Sa jemi të përgatitur si qytetarë të cilët neve do t'i japim legjitimitet? Ne e dimë se, dhe jam banor i asaj lagje dhe kam ngritur zërin qysh më herët për atë deponi ekzistuese, të cilat, janë shkelur të gjitha parimet, të gjitha anët ligjore janë shkelur se si duhet të ekzistojë një deponi. Kur është hapur janë përdorur fjalë madhështore, se kjo do të veprojë kështu, do të veprojë ashtu, duhet ekskavatori të jetë në gatishmëri për mbulesën e tyre. Mirëpo sot qytetarët e asaj treve, e sidomos banorët e fshatit Brezne, janë janë të rrezikuar në gjendjen shëndetësore në shkallë të lartë, sepse të gjitha kriteret që ekzistojnë janë të shkelura se si duhet të veprojë ajo deponi. Ndërsa, neve tash kur po mendojmë për deponi të materialeve të ngurta, duhet të paktën të bëhet një studim i mirëfillët nga drejtoritë për planifikim hapësinor, të cilët duhet të dalin të bëjnë analizën e mirëfillët ku është ai vend-lokacion, jo të dalin vetëm qytetarët e thjeshtë, po du, s'po du, apo po bon e s'po bon. Duhet të dalin ekspertë të fushës, të mendojnë mirë dhe në fund të jepet versioni dhe mendimi se ku duhet të ekzistojnë ato deponi. Sepse neve, në fakt po e çojmë dorën për një deponi të materialeve të ngurta, po mos të harrojmë se 20 e sa vite mas lufte kush nuk është dënue për hedhjen e mbeturinave, të cilat janë me qindra deponi të cilat ekzistojnë nëpër këtë trevën tonë dhe asnjë masë nuk është duke u marru për to. Dhe neve duhet të mendojmë mirë çka po e çojmë dorën, sepse ato nga materiale të ngurta mund të shndërrohen në deponi të cilat do të jenë katastrofike për shëndet të qytetarëve dhe për të tjerët. Faleminderit!

Uran Halimi: Faleminderit, z.Gashi! Dikush tjetër a do me e marrë fjalën? Nëse jo, atëherë e hedhim në votim. Është fjala për pikën e tretë, pa parcelën domethënë, edhe propozimin për largimin e parcelës së parë. Kush është pro kësaj pike të rendit të ditës? Domethënë, e kemi propozimin e

kryetarit, po largohet ajo parcela e parë në listë, që e kemi në propozim-vendim, edhe po shtohen aty dy që janë në vendim, që e keni marrë veç vendimin tashmë. Domthënë, po largohet parcela me numër 706040036-00008-0, edhe po shtohen dy parcela të tjera të cilat i keni në vendim. Kush është pro kësaj pike të rendit të ditës me propozim-ndryshim? U ndryshue çka keni kërkue qetash. Kush është kundër kësaj pike të rendit të ditës? Abstenim? Atëherë i kemi 16 vota pro, zero kundër edhe 6 abstenime, kalon edhe pika e tretë e rendit të ditës. E patëm atë propozimin e z.Naser Myrtezani, për shpallje të interesit publik, me qëllim të përcaktimit të lokacionit...jo more, nuk është kjo. Sidoqoftë, e kemi domethënë pikën e re të rendit të ditës, të cilën e futëm përpara votimit të rendit të ditës, për shpalljen e interesit publik të asaj pjesë përballë Stacionit, ku gjendet tashmë pompa. Unë kisha ftue ndojnë përfaqësues që me na dhonë ndonjë sqarim, a kemi të drejtë na me e shpallë interes publik, në pronë të kujt është, janë hulumtue domethënë komplet dokumentacioni, apo po marrim ni vendim të cilin nesër mundin me na kthye prapë. Kush po na jep ni sqarim nga ekzekutivi, ju lutem!

Qamil Kolloni: Përshëndetje për të gjithë! Ju, të nderuar delegatë, propozim-vendimi që të shpallet zonë me interes të përgjithshëm është në interes të Komunës së Dragashit, për vetë faktin se Stacioni i Autobusëve do të kthehet në menaxhimin e Komunës. Gjithashtu kjo pjesë, pavarësisht se sa do të na kushtojë, është me rëndësi që ta kthejmë në interes të përgjithshëm dhe presim që ky vendim të miratohet. Në qoftë se jo, ne do ta bëjmë edhe shpronësimin e asaj, për vetë faktin se është ngulfatë qyteza e Dragashit. Dhe për këtë arsye na kërkujmë që në radhë të parë të votoni ju, që t'i ktyjmë procedurat e shpalljes në interes të përgjithshëm të këtyre dy parcelave që janë rruga edhe pompa e benzinës, dhe pastaj shohim me proceduart tjera të cilat do t'i vazhdojmë.

Uran Halimi: Faleminderit! Dikush tjetër a do me e marrë fjalën?

Driton Ademi: Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë! E para drejtor, kur të dalish me folë këtu, mos thuj propozim-vendim, po thuj vendim, se e ke pru si vendim, se qe dy-tri herë, edhe Shpeta duol e të tha, e ke pru si vendim. Sqarim të detajuet nuk dhaje për qeto, se na nuk e dimë as e kuja është ajo parcela, as qetu nuk po shkruen a kuja është qekjo parcela. Nuk dhaje kurrfarë detaje, sa herë po bini pika të sponzorizume qetu, nuk po jepni detaje ma të hollësishme. Unë po kërkuj që ma mirë me e marrë ni informacion ma të gjerë, edhe me e pru ma mirë në seancën e ardhshme, edhe për me e votue të gjithë. Jemi për me votue, nëse është në interes të Komunës jemi për me e mbështet. Mënyra ma e mirë është me e lonë në seancën e ardhshme, masi edhe ju s'keni ni sqarim edhe na s'po dimë çka me votue te qekjo. Faleminderit!

Uran Halimi: Faleminderit, z.Ademi! Ni sekond veç, jo, ju lutem! Te neni dy në vendim thuhet që kjo është pronë shtetërore. Qetash, sa është e vërtetë nuk e di. Fjalën e ka z.Munir Jonuzi, pas tij fjalën e ka kërkue z.Nedžmidin Sejdilar. Drejtor, shkruj pyetjet, në fund e kie edhe ni herë fjalën nëse kie diçka me shtue.

Munir Jonuzi: Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, do të doja të pyesja qeverinë, kur të deklarohet interesi publik për shpronësimin e kësaj pasurie të paluajtshme, dhe nëse qeveria ka planifikuar diçka për të ndërtuar në atë vend apo nëse thjesht dëshironi ta mbroni këtë vendndodhje nga privatizimi. Nëse është mbrojtje ndaj privatizimit, unë jam pro këtij vendimi. Nuk më shqetëson që kjo është dhënë para mbledhjes së seancës së Kuvendit dhe ne kemi pasur propozime të tilla edhe në të kaluarën. Duke qenë se është Dragashi dhe vendi ku kalojmë, nuk shoh ndonjë arsye të veçantë pse kjo të mos shpallet çështje e interesit publik. A keni planifikuar tashmë të ndërtoni diçka në atë vend.

Nedžmidin Sejdilar: Ky dokument mori 70% të kohës sonë të diskutimit sot. Kur pashë dokumentin, ajo që më tërhoqi vëmendjen ishte se keni shpenzuar një shumë të madhe parash për

tonerët dhe nuk mund të lexoj se çfarë shkruhet në këtë dokument. Keni shpenzuar 38,000 euro për furnizime zyre. Me intereson pse qeveria juaj ka standarde të dyfishte. Kur bëhet fjalë për interesin publik të qytetarëve, ne do të deklarojmë çdo vend me interes publik, por vitin e kaluar u lodha duke kërkuar që të plotësohej kërkesa e qytetarëve të fshatit Mlike, të cilët gjithashtu kërkojnë që të deklarohet një objekt me interes publik dhe të sjellë në Komitetin për Komunitete. Kjo kërkesë është dorëzuar në qershor 2022. Një vit tashmë. Pse duhet të jene gjithmone standarde të dyfishte. Kur dikush nga Mlika, Restelica, Krstaci bën një kërkesë, atëherë ajo kërkesë hidhet vetëm në një fiok. Kjo më shqetëson më shumë. Keni vota, mund të caktoni një seancë të jashtëzakonshme në 4 ditë. Dhe jo këtu na e dorëzoni dokumentin si nga tostieri. Si ta analizoj këtë? Çdo njeri normal do të thotë se është një lojë dhe jo gjithçka është e pastër. 24 minuta pas kohës së rregullt, nuk është e drejtë, nuk është etike, nuk është profesionale. Më vjen keq t'ju quaj praktikues amatorë, por kjo e vërteton këtë.

Uran Halimi: Faleminderit, z.Sejdilar! Dikush tjetër nëse do me e marrë fjalën?

Qamil Kolloni: Driton, bone pyetje për pronësinë. Në qoftë se e ke lexue, të shkruen pronësia. Pyete zyrtarin ligjor për atë çështje dhe kryesuesin e Kuvendit. Në rregull, dëgjo, këtu po të shkruen shumë mirë që është pronë shoqërore dhe po të tregon edhe hapësirën sa edhe krejt. Tash si të duesh me majt fjalim edhe me e zgjat, na po e zgjatim ose po ta lexoj prej fillimit qysh është i shkruem vendimi. Mirëpo mu po ma merr mendja për gjonat të cilat janë të lexueshme edhe janë të dukshme, nuk ka nevojë me dhonë shumë sqarim. Pastaj në nenin tjetër, masi të merret ky vendim edhe të na kthehet i ligjshëm, hapat tjerë i merr kryetari dhe stafi, shkruen shumë mirë. Qysh mundim na me planifikue derisa s'e dimë a është pronë e jona, delni boni pyetje, për shembull, që janë hipotetike. Qysh mundish me ditë ti çka kie me bo aty, derisa s'e dish ni herë a është e jotja. Na e kemi marrë iniciativë ni herë me e kthye në pronësinë tonë, pastaj janë organet, janë inxhinierat, janë arkitektat që bojnë çka...ose edhe ky Kuvend munden me ia dhonë destinimin, në qoftë se ka nevojë përmes këtij Kuvendi me marrë edhe ni vendim tjetër, si çka me e destinue. Mos boni gjona hipotetike, edhe tash po na qitni në pozitë të palakmueshme, sikur me marrë me i lexue gjonat prej fillimit, çka po bojmë nesër, çka do të bojmë masnesër. Pra, vendimi është shumë i kjartë, ta kthejmë në pronësinë tonë, ta shpallim zonë të interesit, masi të kthejmë këtë vazhdojmë me hapa të tjerë, të shkruen shumë mirë. Unë nuk e di, në qoftë se nuk e shohish, e kie skicën, qe ku është nxjerrë, numri, shifra, metër katrorë. Tash, çka duhet me dhonë sqarim këtu? Është çështje tjetër kur dona me majt debat politik, edhe marrim bisedojmë çka dona na. Na, do herë, për çështje të modestisë, e kemi çue projektin në IPA 2, e kemi parapa komplet se çka bohet, 570 mijë euro për m'u bo deponi inerte. Janë të parapame blerja e kamionit, damperave, shumë investime të mëdhaja. Për herë të parë peshoret kanë me u bo, m'u mat para se me u hedhë mbeturinat. Ka me u bo ndarja e tyne, dhe të gjitha këto nuk po i thona, për hir të modestisë edhe për hir të kohës, sepse na jemi t'o luftue me kohën, i kemi pru disa vendime që duhet ta nënkuptoni, për shkak të kohës i kemi pru këtu, se do të gjejmë ni gjuhë të përbashkët me ju si delegatë, se edhe ju jeni të interesuet si na, që ta zhvillojmë këtë vend, për arsye se është bo qysh është bo, janë bo qysh janë bo deri në këtë rast, na nuk po hymë me i gjykue. Gjonat të cilat ka qenë dashtë shumë ma herët me i marrë këto vendime, se janë konë në Planin e juaj zhvillimor të përcaktume këto zona, edhe të ndame, edhe të destinume për këto çështje, dhe nuk janë marrë për 14 vjet dhe tash po duhet për hir që po konkurojmë nëpër fonde të ndryshme, me e kompenzue humbjen edhe në kohë edhe në vendime që me kohë nuk janë ekzekutue. Pse i keni parapa këto zona më 2013-tën dhe nuk keni mund t'i finalizoni deri më 2022-tën. Edhe duhet në 2023-tën, në momentin kur të

konkurojmë në Projektin IPA, t'ò e ditë se i keni zgjidhë këto probleme kur i keni caktue këto zona, na dalin se janë të pylltarisë. Dhe po na duhet me intervenue, pronën tonë me e kthye shpejt e shpejt për me mund me përfitue. Dhe na nuk po dona me ju majt fjalime politike, ju detyrimisht po na shtini, prandaj të jemi pak të sinqertë me vetveten, edhe politikë kur të bojmë, kryesues, edhe politikë kur të bojmë është mirë ni herë me pyet mor burrë.

Uran Halimi: Jo jo, nuk është puna politika, prit qetash se kemi me e sqarue këtë muhabetin, veç kryje fjalimin.

Qamil Kolloni: Po, unë e përfundova.

Uran Halimi: Kryetar, me dhonë ni sqarim që ta kanë pyet delegatët, Veç ni sekond, kryetar. Ma interesant po më vjen kur po thotë a s'e keni lexue, kur qysh me lexue kur qetash erdh. Pjsea tjetër, e ka të shkrueme, edhe vetë s'e ka lexue, ku qëllimi i shpalljes së interesit publik, kështu shumë qartë, në parcelën e shënuar po thotë, është ndërtimi i infrastrukturës. Edhe ti s'e ke lexue drejtor, edhe mandej po thuesh s'e keni lexue. Tjetra, për qeto po të akuzojmë, mos bjer pika Ad hoc se po ngjallin debat edhe mandej po të shtijnë me bo edhe politikë. A po kuptojsh? Mos bjer pika Ad hoc, edhe ni muj ditë e kishna analizue shumë mirë me ni seancë të radhës. Ose para ni jave, në material të seancës ke mund me e shti. Pse Ad hoc, pse shpejt? Çka ka urgjencë këtu? Mos u boftë rrethi këtë muj, bohet muajin tjetër, ashtu-ashtu projektet ka dy-tri vjet po zgjatin, po nisin edhe po jesin në gjys. Sidoqoftë, line politikën, qetu po shkrun ka m'u ndreq infrastrukturë rrugore, dikush tha që ka me u marrë e ka me iu dhonë dikuj tjetër, - jo, Munir - domethënë qëllimi është për infrastrukturë rrugore. Këshu që interes publik kongra, s'paska interes personal kërkush. Atë rrethin e rrugës kur ta bojmë, s'më vyn as mu, as kërkuj personalisht, krejt e shfrytëzojmë. Ishalla bëhet bukur, se profesori Nexh vazhdimisht e ka akuzue qeverisjen me investue në Dragash. Unë kam qef me investue në Dragash, se nime komuna jonë është, edhe e krejt qytetarëve tanë. Po besoj që është nismë e mirë, mirëpo gabimi që po e bojsh, drejtor, ose ekzekutivi, përnime me qeto pika Ad hoc, po ju lus kështu si kryesues e si delegat e si koleg, mos më bini bre mo këso pika në stilin karate, se s'ka kurrëfarë kuptimi. Dikush tjetër a po do me e marrë fjalën? Kryetari e pat fjalën edhe mo po e përmbyllim këtë diskutim. Edhe masi ta përmbylli ty ta jap fjalën, veç lype.

Bexhet Xheladini: Të nderuar delegatë, asambleistë! Pse ka ardhë në mënyrë urgjente ky propozim, i ka arsyet e veta, edhe keni të drejtë ju që po jepni vërejtje. Vërejtjet i keni me vend. Por, është diçka ma madhore sesa vërejtjet që po i jipni. Ekzistojnë disa arsye pse e kemi pru na këtë. Ju e dini që asnjërit prej jush nuk ju konvenon ajo me mbet si pompë, e ka ngulfatë Dragashin, aty duhet të bëhet diçka tjetër. Ekzistojnë disa frika, disa paralajmërime që mund të privatiozohet së shpejti...paragjykime, jo, nuk janë paragjykime. Ju e dini që Asambleja e ardhshme munden me u thirrë mas ni muaji, masnej deri të vjen ai vendimi i ligjshëm ose i paligjshëm, shkon një kohë. Na e kemi pru këtë vendim, është e drejtë e juaja ose mos me e votue, unë nuk ju përzihem këtu. E jemja është konë me e pru ugjent këtë, e juaja është me vendos. Aty do të ndërtohet ni infrastrukturë, dhe nëse bëhet kjo pronë e jona, e komunës, do të mbajmë ni debat publik me qytetarë, me këtë Asamble, edhe do të vendosim së bashku se çka do të bëjmë, a do ta bëjmë rreth, apo do ta bëjmë ndonjë parking për taksista, apo do të bëjmë diçka tjetër, është çështje që nuk kam me vendos unë, do të vendosni ju, do të vendosin qytetarët e Dragashit, po nuk humbim na kurgjo nëse këtë pronë na e kthejmë si pronë komunale, edhe mandej vendosim na vetë çka do të bëjmë. Është me rëndësi me e zonë hapin, mos me u vonue. Ajo deri para ni muaji ka qenë pompë, është mbyllë, janë vu disa rrethoja aty, është ndalue, tash janë disa plane që ajo të privatizohet ose të shndërrohet në diçka tjetër,

nuk e di, po mirë është që atë ta kthejmë në pronësi të komunës. Vendosi ju. Keni të drejtë që lypet sqarime shtesë, për arsye se materialin e keni marrë sot, s'keni pas kohë me e lexue, mirëpo është me rëndësi që ju ta merrni ni vednim ta shpallim interes të përgjithshëm si komunë, pastaj prapë na do të vendosim bashkë me ju. E di që edhe intersi i opozitës është që Dragashi të duket mirë, të duket i bukur, mos të duket i ngulfatur. Ajo është hyrja e Dragashit. Na do të bëjmë diçka edhe me Stacionin e Autobusëve, por jo unë, unë jap propozim, do të bije këtu, do të vendosni ju, edhe është në dorën e juaj me vendos për ose kundër, nuk është problem. Faleminderit!

Uran Halimi: E ka veç ni minutë z.Jonuzi, mandej fjalën e ka Samidin Xheladini, pas tij z.Nedžmidin Sejdilar. Me ka ni minutë, ju lutem!

Munir Jonuzi: Sigurisht që lexova nenin 3 që thotë se kjo parcelë do të përdoret për ndërtimin e infrastrukturës dhe rregullimin e qendrës, megjithatë duket se është gabim, ndërsa dikush po fliste nga qeveria, dëgjova se parcela do të përdoret për ruajtjen e materialeve të ndërtimit. Kështu që ishte pak e palogjikshme për mua. Ky ishte përkthimi. Kështu që doja të shihja se çfarë po ndodhte. Ju Kryetar keni bërë propozim të qelluar dhe sigurisht që më vonë do të vendosni se çfarë do të jetë aty, një park apo një rrethrotullim. Shërbimet komunale, në bashkëpunim me qytetarët, do të përcaktojnë se çfarë është më e mira për ta.

Samidin Xheladini: Katundi që doket nuk do kallauz! Këtu na kemi pas, kur ka qenë Salim Jonuzi dhe Lulzim Rifaj kryesues, kemi pas ni propozim që pronat e Komunës t'i marrim prej AKP-së edhe t'ia kthejmë titullarit, sepse në ish-Jugosllavi i janë marrë pa të drejtë Komunës, i janë marrë tokat. Qysh janë marrë ata e dijnë, në ish-Jugosllavi, kur ka qenë Beadin Ahmetoviçi, i janë dhënë Sharrprodhimit, Sharrprodhimi u bë tash privatizimi, na kemi dashtë, domethënë, atë me e çue në vend. Jemi konë në opozitë na. Me unanimitet të gjithë delegatët, pozitë-opozitë, e kemi përkrahë fuqishëm edhe i kemi dhënë mbështetje, sa që ka ardhë puna që Salim Jonuzi edhe Lulzim Rifaj kanë pas edhe probleme me ligjin, AKP-ja ka ngrit domethënë procedura gjyqësore. Për ata që s'e dinë po ju njoftoj, ata që e dinë, e dinë. Atëherë domethënë ka qenë pronë e AKP-së. Pse na pronën tonë, që është e jona, të mos e menaxhojmë na, po të merr e ta menaxhojë dikush tjetër? Është momenti që ndoshta, në qoftë se tash na nuk marrim hapa të ngutshëm, sepse punë e kemi na, obligim e kemi, se na jemi qytetarë të qesaj komunës. Unë pak pares s'dashta me ndërhy, se ndoshta u merrke si tendencë, se shpejt-shpejt qata banorët e Rrencit, qat pronën që boni kryetari shumë mirë që e tërhoq, se e pa që është me tendencë, qat pronën kanë me e lyp me e kthye po s'kanë me mund. Se tash Ministria e Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ka me i marrë kompetencat, edhe atëherë e shohim a 'un p'e kthejmë qat pronën. Edhe këtu, mos të bëjmë debate, se çdo pronë që na takon neve – na pronën tonë jemi t'ia kthye titullarit, e asnjoni s'e marrim na qetu në shfrytëzim as përmi veti. Domethënë me ia kthye qytetarëve. Ju faleminderit!

Uran Halimi: Shumë faleminderit! Më pëlqeve kut i përmende ato rastet ku i kanë kthye, edhe ajo u konë tokë e komunës tonë. Kanë tentue me e kthye, kanë ra ndesh me ligjin. Kur thaje kush na ndalon për me e kthye, konga ligji ai që po na ndalojka, na po i tutna ligjit, i nderum delegat. E po këtu është problemi, se na nuk po e dimë a kemi probleme me ligjin, qato na ka ardhë vendimi shpejt, për qeto na po diskutojmë. Këtu është problemi. Fjalën e pat z.Sejdilar, ni minutë të lutem!

Nedžmidin Sejdilar: Ju thatë që qeky propozim-vendim, vendim-propozim, çka është, nuk e di as e kuptoj, është urgjent. Kryetar, faleminderit shumë, unë të respektoj si kryetar, si njeri. Faleminderit për respekt, le të jetë ky shembull karshi qytetarëve. Unë e di që ju talleni shumë edhe me ne delegatët edhe me qytetarë, po le ta sheh qytetari, të vazhdon përsëri. Qetash unë nuk do të tallem me ju, po

do të ju kritikoj, sepse ju thatë që qeky dokument është me urgjencë. E keni pru me urgjencë, çfarë dokument është, a është vendim, a është propozim-vendim, a çka është, nuk është me rëndësi, se juve s'ju kuptoj, sepse jeni praktikantë amatera. Thatë që është me urgjencë. Urgjenca a s'u konë dje me pru në ndonjë komitet këtë dokument? Dje e kemi pas KPF-në dhe Komitetin për Komunitete. Kur ju erdh kjo urgjenca, mas orarit të punës? Si ka mundur me ardhë urgjenca mas orarit të punës, nuk e di. E para, e dyta i nderum kryesues, ju si kryesues e keni përgjegjësinë, sepse ky dokument e ka nënshkrimin Uran Halimi – kryesuesi, nuk e ka Bexhet Xheladini – kryetari i Komunës. Kur e keni pa një gjë të tillë, u desht me e shfrytëzue ju autoritetin edhe me e lonë për ndonjë seancë të radhës. Tjetra, në qoftë se është kaq urgjent, i keni bre nënshkrimet, ni seancë të jashtëzakonshme, mblidhemi krejt këtu, debatojmë, e rregullojmë. E treta, kur shpallet interesi publik, duhet me e ditë në atë vend çka bëhet. Na vitin e kalum e kemi shpallë interes publik për objektin e Ministirsë së Punëve të Brendshme në fshatin prej të cilit ju vini, kryetar. Po e kemi ditë që atje ndreqet park. Unë po du qetash me e ditë – nuk është problem me e shpallë, e shpallim – po unë po du me ditë çka keni me bo aty, çka do të bëhet, a do të bëhet tunel, a bëhen semafora, a bëhet rrethrotullim, a bëhet park, parking, garazha, shopping center, çka bëhet në atë vend? E shpallim, nuk është problem, po ju duhet me na pru ndonjë projekt ose ndonjë propozim, naj ide, çka duhet m'u bo aty.

Uran Halimi: Shumë faleminderit, z.Sejdilar! T'ia jap ni përgjigje veç. Unë me e shfrytëzue autoritetin, qysh tha parafolësi, çka të shfrytëzoj autoritetin kur, nëse unë s'e bëj ni kërkesë ose s'e qes në votim ni propozim, akuzohem që duhet unë me e qit. Në momentin kur unë e qes në votim, me e shfrytëzue autoritetin, s'kam qef me e shfrytëzue autoritetin, kemi njerëz këtu që e shfrytëzojnë autoritetin, i dimë tashmë kush janë ata. Kështu që kur të bëhet vendimi edhe nënshkrimi i kryesuesit, edhe qetu po shkrun qëllimi i shpalljes së interesit publik, qëllimi publik ligjor, në kllapa, në parcelën e shënuar, të përcaktuar në pikën e dytë të këtij vendimi, është ndërtimi i infrastrukturës dhe rregullimi i qendrës për nevojat e Komunës së Dragashit. Nëse unë e nënshkruaj këtë vendimi, me qet kushtin qetu, edhe nesër rregullohet diçka tjetër atje, qaj nënshkrimi jem ka me e rrënuë atë rregullimin, Nedžmidin, edhe nuk ka me lejue. A po kupton? Se vendimi nënshkruhet me qeto kriteret. Nuk ndryshohen kriteret, hajde p'e votojmë ama po ia ndryshojmë kriteret, p'e bojmë atje ku me ditë çka. Fjalën e ka z.Spahiu.

Mehmet Spahiu: Përshëndetje kryetar, përshëndetje asambleistë e asambleiste! Ajo që më shtyri ta marr fjalën këtu është prononcimi i ripërsëritur i z.Nedžmidin Sejdilar, i cili kryetarin – i cili i ka mbi 6 mijë vota, i cili i ka rreth 40 vite shërbime pune – e quan praktikant. Ne si asambleistë nuk mund të tolerojmë shprehje të tilla, z.Nedžmidin, të na fyesh kryetarin në këtë formë, ta fyesh kryetarin e Komunës së Dragashit, i cili me vota të ligjshme ka ardhë këtu kryetar i Komunës, edhe ti të çohesh ta quash kryetar praktikant, është fyerje e rëndë. Ti nëse duesh me e tregue veten se je delegat i përgjegjshëm, duhet të dalësh t'i kërkosh falje kryetarit edhe të gjithë asambleistëve, edhe kryesuesit të Asamblesë. Ndryshe, kjo formë e paraqitjes tënde është denigrim i popullatës që e parfaqëson. Ju faleminderit!

Uran Halimi: Faleminderit, z.Spahiu! Realisht është mirë me e rujt gjuhën. S'është veç kryetari që e kanë fye, më kanë fye edhe mu, më kanë thonë që jem i padijshëm. Sidoqoftq, na qaq dijmë edhe qaq jemi të pjekun, edhe çdo konstatim i ni personi në fjalë kundrejt ni personi tjetër është veç konstatim i tij, nuk është diçka e mirëqenë ose e qëndrueshme. Mos e merrni si të qëndrueshme. Unë, për shembull, ni konstatim të ni delegatit ose të ni qytetarit të thjeshtë që më thotë unë jam i padijshëm, e pranoj, e kuptoj si konstatim të tij, s'un ia ndërroj mendjen. Tjetra është që, për m'i

thonë dikuj je i padijshëm, ose si rasti në fjalë, praktikant amater, duhet m'u konë nifarë testuesi, nifarë ekspert i qasaj lëmie. Për shembull, i padijshëm, në çfarë lëmie jam unë i padijshëm, ka raste që ka gjermanishtja hiç s'ma rrok, ama në anglisht jam i dijshëm se më ka testue ni profesor. A po kupton? Ma ka dhonë ni provim ose ni diplomë. I padijshëm në çfarë aspekti, praktikant në çfarë aspekti, se qysh tha edhe z.Spahiu, në aspektin profesional e ka dëshmue që është i dijshëm, nuk është praktikant. Bën unë kur të them. Kështu që lëni gjërat personale, p'e kryejmë punën për të cilën jemi të thirrur këtu, edhe po vazhdojmë me pi kafe, se na kur të dalim këtu, edhe qytetarët e dijnë që pimë kafe prapë bashkë. Jemi shumë shokë, kapak folim edhe diskutojmë, ndonjëherë edhe me gjuhë të ashpër, po e mira është që jo bash qysh doken sendet janë. Vazhdo, Nexho!

Nedžmidin Sejdlar: Faleminderit kryesues për ligjëratën, do ta konsideroj. E para, e dyta, i nderum z.Spahiu, unë respekt kam këtu për të gjithë. Kur kam thonë praktikant amatera, nuk kam thonë për profesionin e doktorit edhe nuk i kam thonë për kryetar, i kam thonë për qeverisje, që kjo qeverisje aktuale, me këtë dokument, me mënyrën qysh na keni sjellë dokumentin në Kuvend, nuk na tregoni kurgjo ma tepër, që jeni praktikant amatera. Qashtu e keni pru dokumentin, unë me fakte foli. Ofendim kurrë prej kësaj foltore nuk kam bo unë. Në gjëra personale s'kam hy asnjëherë në këtë foltore. I nderum kryesues, kur të them ty autoritetin me e shfrytëzue, nuk thashë autoritetin me shfrytëzue duhet me bo diçka të madhe. Autoritetin institucional, se na shumica këtu po debatojmë pse ky dokument erdh 24 minuta mas kohës së seancës, edhe ti neve po na thuesh unë nuk e qes nënshkrimin. S'u desht me e pru ti këtë dokument me nënshkrimin tënd. Kryesues qe, kahmos ku po e çelish, Uran Halimi shkrun. Po ky është propozimi yt, kryesues. Masi këtë vendim duhet me e nënshkru ti, ky është propozimi yt, nuk është propozimi i kryetarit. Unë të thashë ti u desht me e shfrytëzu autoritetin mos me e leju pushtetin me na sjellë dokumentet këtu. E këto që thashë puna e praktikant amaterëve, duhet me vepru që jeni profesionista, atëherë ju livdoj.

Uran Halimi: Shumë faleminderit, i nderum Sejdlar! P'e hedhim në votim pikën e katërt, propozimin për shpalljen interes publik të asaj zonës kadastrale ku është pompa, përballë Stacionit të Autobusëve. Kush është pro këtij propozimi? Kush është kundër? Abstenim? 19 vota pro, 1 kundër edhe 4 abstenime, kalon propozimi i z.Myrtezani për shpalljen e interesit publik të zonës në të cilën gjendet pompa përballë Stacionit të Autobusëve në Komunën tonë. E kemi pikën e fundit edhe eventualen. Te eventualja e ka kërkue fjalën...unë kesh t'o vazhdue more, unë s'thashë kurgjo, unë menova që p'e lypin fjalën, s'kesh t'o ndërpre. Atëherë, disa delegatë kanë ftesë për me shkue në një takim zyrtar, ata që kanë ftesë mundin me shkue. Pikën eventuale mundim mos me folë hiç edhe me e krye, se s'o pa qare. P'e vazhdojmë, kush do me e marrë fjalën? Fjalën e kërkoi z.Nexhat Selaj, pas tij fjalën e ka z.Nedžmidin Sejdlar, pas z.Sejdlar fjalën e ka z.Artan Loshaj.

Në rregull, e anuloi kërkesën për kërkim fjale z.Nexhat Selaj. Pas tij fjalën e pat z.Nedžmidin Sejdlar. Mundohu regjia me ma garantue kuorumin.

Nedžmidin Sejdlar: Tani kur të paraqes argumente për keqpërdorimin e buxhetit komunal, atëherë autoritetet do të thonë se po i provokoj. Fakti është se kjo qeveri komunale e subvencionoi OJQ-në që organizoi festën e goranëve nga buxheti i komunës dhe themeluesit e OJQ-së ishin në listën boshnjake. E kam fjalën për kandidatët në zgjedhjet e mëparshme. Unë jam duke folur për një person që është një delegat i mundshëm këtu. Nëse dikush nga ajo listë largohet nga kuvendi, ka mundësi që zonja që është themeluese të jetë delegate e këtij kuvendi. Qeveria komunale i dha asaj zonje subvencione për të cenuar dinjitetin e komunitetit goran, për të nënçmuar goranët, për të organizuar ditën e goranëve, për të cilën edhe dita zyrtare u zhvendos prapa. Në vend të 6 majit,

dita e goranëve u organizua më 5 maj. Zonja ishte në listën boshnjake me numrin 9. Kështu erdhi zoti Murtezani këtu në kuvend. Ne e dimë se krijimi i një OJQ-je është në konflikt të drejtpërdrejtë me ne delegatët. Sot do të diskutoj për dy çështje dhe ju kërkoj zotit Jonuzi dhe kryetarit të Kuvendit të hetojnë nëse këtu ka konflikt interesi. Së pari: që një delegat i mundshëm rezervë mund të themelojë një OJQ, e cila është themeluar më 21/02/2023 dhe e subvencionuar tashmë një muaj e gjysmë pas kësaj, dhe e cila organizoi Ditën e Goranit më së keqi. Është njësoj sikur të themeloja një OJQ dhe të organizoja festivalin “Opoja vallzon”. A do të ofendoheshit. Në Gorë kishte goranë dhe boshnjakë. Për mua është ofenduese që një person nga lista boshnjake më organizon ditën e goranëve dhe plus që e ndërron datën dhe e lë 6 majin në baner. Kërkoj që të hetohet konflikti i interesit dhe të nisnin procedura të tjera dhe të ndëshkohen ata që kanë shpërdoruar detyrën. Më datë 13.12.2021 bëmë betimin dhe morëm mandatin e delegatëve. Në mesin e janarit 2022, z. Miralem Rahte themeloi një OJQ. A është ky një konflikt interesi? Mua më intereson vetëm nëse Miralem tani është sektor joqeveritar apo i deleguar. Cilin funksion e shtyp tjetrën. Më intereson nëse tani kam të drejtë të themeloj një OJQ. Çfarë është Miralem, një OJQ apo një delegat politik? Plus, po e subvenciononi nga buxheti i komunës. Komuna i ka dhënë 4000 euro për projektin. Ju kërkoj zoti Jonuzi të kontaktoni Gjykatën Kushtetuese, për të parë nëse është delegat apo OJQ. Nëse ai ka të drejtë, atëherë të gjithë kemi të drejtë. Do të marrim projekte nga buxheti dhe gjithçka do të lulëzojë për ne. E treta: qytetarët e Restelicës pyesin se kur do ta rehabilitoni Shtëpinë Shëndetësore në Restelicë. Kështu duket ai. Njerëzit janë të shqetësuar, nuk ka drita. Njësoj atje, kur kontrolloni rrugën, të rregulloni fillimisht ujërat, jo kubza fillimisht, që ta bëni dy herë. Doja të pyesja presidentin, peticionin që është në proces, më intereson kush ju jep të drejtën të jepni informacionin privat të nënshkruesve dhe më pas disa rrethe pranë jush thërrasin njerëzit me telefon dhe i vendosin në situata të pakëndshme dhe kërcënojnë ata. Është një veprë kriminale. PSD-ja është dënuar me 20 mijë euro gjobë vetëm sepse në mënyrë simbolike kanë dorëzuar një peticion para ndërtesës së qeverisë. Ju mund t'i verifikoni nënshkrimet në institucionet kompetente të shtetit, por nuk keni të drejtë t'i jepni emrat e nënshkruesve në disa sfera interesi që më vonë i bëjnë ata njerëz të mos ndihen rehat, i kërcënojnë apo kërcënojnë në çfarëdo mënyre integritetin e tyre privat.

Uran Halimi: Fjalën e ka z.Samidin Xheladini, pas tij fjalën e ka z.Artan Loshaj.

Samidin Xheladini: Nedžmidin, ma ke përmend emrin, duhet me ngue! Unë deshta me ta bo ni pyetje ty, se debatet që i kam bo unë, gjithmonë në ish-Kuvende, kam kërkue që së pari të futet kanalizimi, uji, e masnej të bëhet infrastruktura. Kur kanë ndodhë këto punime, në cilin mandat, edhe para cilave vite janë bo punimet, për Restelicë? Edhe e dyta, në ambulant, qe sa kohë nuk është renovue ambulanta, edhe, unë me sa e di, tash sivjet ka m'u renovue. Se neve na vyn... kqyre, ngo tash, ti e ke dhonë me argumente, po neve na vyn realiteti, se marketing këtu nuk mundim me bo. Këtu duhet me e folë të vërtetën. Në qoftë se dalim na këtu dona me u propagandue, ose m'u kallxue që unë di edhe unë po foli, atëherë s'është edhe në rregull. Po duhet ti t'i adresosh çështjet aty ku janë, në cilën kohë kanë qenë punimet kur janë bo, ku s'është shti uji, kanalizimi, edhe u kubëzue. Se unë në çdo seancë kam kërkue që kjo të bëhet paraprakisht, para se me u bo, në ish-qeveritë e kalume. Edhe ambulantën qe sa vite domethënë, ti je krah i opozitës dhe ti je me PDK-në në koalicion. PDK ka qenë në pushtet. Qe sa vite s'u investue asnjë cent Restelicë? Mos hajde këtu me bo atë formën e kamuflimit edhe me ia gjujt topin dikuj. Edhe sa për renovimin, unë e pashë prom, drejtori më njoftoi, se ambulanta e Bresanës edhe e Restelicës është në plan m'u renovue, qysh më tha drejtori i Shëndetësisë, edhe për disa ambulanta të tjera. Faleminderit!

Artan Loshaj: A munda me vazhduer? Po, shpejt e shpejt. I nderuar kryetar, edhe dje kemi diskutue po për hir të inçizimeve, se s'po m'i jepni inçizimet për m'i publikue unë që po foli, jam i obliguot sot me dalë para jush për në eventuale. Ti e dish që e kam pikë të dobët shëndetësinë edhe e kam pas gjithmonë. Kemi disa probleme aty, që po rriten edhe po shtohen çdo ditë. Po më vjen keq pse sot Ventaza iki, se njëra prej tyre është edhe ajo që preket direkt. Problemi është në ni, është mungesë e stafit të urgjencës. Keni pru ni infermier prej orës tre deri në ora dhjetë, po prapë mas orës dhjetë është ni infermier me ni motër. Ni, e dyta, thirrmi me dalë në teren nëpër aksidente, dhe si mjekë, si specialistë, si punëtor katërdhjetëvjeçar, mujsh me na tregue shumë lehtë, se drejtori s'është këtu i Shëndetësisë, po edhe me qenë është mësues, mundesh me na tregue që me ni aksident, ni infermier me ni vozitës çka mujn me bo. Lëndon ma shumë se që ndihmon, apo? E treta është që policia po na bën thirrje, me ni mënyrë na detyron për me dalë atje, dhe na dalim edhe pa zjarrfikës. Si mundish, për shembull, me shkue me e dhonë një ndihmë të parë, kur është, për shembull, ni automjet është rrokullis, edhe na s'mundim me e rrezikue vetveten për me bo, për me pshtue dikond tjetër. Këtu kemi pas shumë raste. Tjetra është kryetar që, unë me thashetheme nuk merrem, po këtë po ta thom që duhet me dalë stafi në ndihmë të qytetarëve, ne jemi për ndihmë qytetarëve, po me ftesën e juaj, me nënshkrimin e juaj ose të drejtorit. Është mirë me na njoftue me shkrim, kemi apo nuk kemi të drejtë me dalë në aksidente. Prej se kemi pa mjekë në Republikën e Kosovës nuk del kërkush nëpër aksidente. Në qoftë se mendoni me dalë, ju lutem na bini me shkrim, edhe rritne stafin, së paku motra që punon aty të rri me mjekun për shërbime të qytetarëve të tjerë, ndërsa dy infermierë me ni vozitës të dalin në aksidente. Problemi tjetër është kryetar, e dini shumë mirë, drejtori iki, s'është problem, kemi diskutue me to që stafit të urgjencës, ku janë mbi 20 punëtorë, janë infermierë, mami dhe vozitës, iu është zvogëluar në mënyrë drastike pagesa e kujdestarive. Arijeta për fat të keq na shkoi sot, pagesa ka qenë 18 euro, tash në Prizren, Prishtinë, në të gjitha vendet ka shkue 33 euro pagesa për infermierët, ndërsa në Komunën e Dragashit ka shkue në 7 euro. Prej orës dhjetë deri në ora gjashtë në mëngjes, ni infermier m'u pague 7 euro. Me të ardhë prej Restelice ose me të ardhë prej Brodosanës, 5 euro t'i hargjon rrugë, 2 euro ni picë s'un e ha. Është mirë kryetar ta zgjidhni këtë problem, se përnime është problem, se edhe qat vullnet që e kanë pas punëtorët, edhe qaj vullnet çdo ditë po zbehet. Nuk jam kundër mjekëve, po mjekëve iu ka rrit standardi, iu ka rrit paga, iu ka rrit edhe koeficienti i kujdestarisë. Ni mjekë, për shembull, të shtunën i merr 250 euro, infermieri i merr 7 euro. Është mirë me i marrë ata, unë nuk jam kundër tyre, se ata e bojnë punën e vet, mjekë na s'mundim m'u bo, veç prej 18 euro ni infermierit me ia rrëzue në 7 euro, e ne Prizren e në Prishtinë kur t'm'i çojnë bashkë me stafin, prej 18 në 33, kjo është e pakapshme edhe të gjithë punëtorët e sektorit të urgjencës, mamitë, infermierat, vozitësit, janë shumë të shqetësuet me këtë gjendje edhe besojmë dhe shpresojmë në kryetarin që të bëjë zgjidhje, edhe për ni arsye se vetë je mjek. Edhe ni pyetje, mos e merrni provokim, po po due me e bo ni pyetje shumë të thjeshtë për z.Naserin. I uroj postin e ri të drejtorit, po po ju pyes juve edhe kryesuesin, a ka të drejtë me qenë edhe drejtor, me qenë edhe asambleist. Faleminderit!

Uran Halimi: Faleminderit, z.Loshaj! Fjalën e ka z.Nexhat Selaj. Veç pak, realisht, për ankesa, ma shumë se ti kam unë në këtë drejtim. Besoj që daja Mujë...domethënë ankesa ka të vazhdueshme, po është mirë me qëndruer edhe me e zgjidhë kismet mandej.

Nexhat Selaj: Përshendetje për të gjithë, përshendetje kryetar! Po më duket se në vazhdimësi po na bëhen këso tollovi palidhje, nuk po muj me kuptue shumë, po po duhet m'u përshtat. Kryetar, kam disa nga pyetjet, ishalla ke durim edhe do të më japësh përgjigje, se shpeshherë i anashkalojsh. Vetë

je deklaruar pak ma herët në ni seancë, se ato pyetjet të cilat kanë vend ju jap përgjigje, këto të cilat nuk kanë fort nuk ju jap rëndësi. Unë besoj se i kam zgjedhë disa nga ato shumë me rëndësi. E para ni herë do të ves kryetar për punimet e kubëzimit dhe rregullimit të rrugës në fshatin Zym. A je i njoftuet edhe a mundish me na dhonë diçka, apo nga Drejtorati juaj, se deri ku kanë arritur ato punime. Unë do t'i cekim disa nga ato, ju sigurisht do të keni durim edhe do t'i dëgjoni, do të më jepni arsye. Dy takime në fshatin Zym të cilat i kam mbajtur, janë të shqetësuar dhe të revoltuar seriozisht. Rruga e cika shpie nga shkolla në drejtim të zonës fushore, aty ku tentohet edhe të punohet fushat edhe tokat, aty ku kemi edhe ni rregullim, ka investue njëri në hapjen e ni ferme, është nënshkrue kontarta më datën 29.03.2023, dhe kontratës i ka skadue koha më 09.05.2023. Unë nuk do të lexoj shumë nga ajo kontratë se çka shkruan, po disa nga ato pika. Të kenë kyçje edhe rrugët dytësore, në pikën 1.3. Në pikën 1.4, të pastrohen të gjitha mbeturinat e ngurta, në pikën 2.1, të hapet kanalizimi dhe të vendoset rërë. Në pikën 3.2, të rrafshohet, të ngjeshet me eskavator të peshave të rënda trashësia e rërës që është 30cm, e në raste të veçanta deri në 1 m të bëhet mbulimi i saj. Koha e punimeve, kryetar, ka mbaruar, unë t'i kam sjellë disa nga ato foto, të cilat i kanë pru banorët e fshatit, të cilat unë do t'i orientoj edhe kah mjetet e informimit, Radio Sharrit, që të shohin nëse është pranue kjo punë që koha ka skadue, që këtu nuk ke as 10cm të shtruar zall të llojit të trashë, rërë të trashë. Kjo është njëra nga ajo tjetra, të cilat do t'i shifni, do të ju lo për me vërejtur, rërën se sa është e shtruar dokumenton kjo foto. As 10cm nuk e ke, kur në projekt shkruan se duhet të jetë 30 minimumi, deri në 1 metër. Ajo çka është ma kryesorja, është deklarue në projekt që t'i mundësohet shansi edhe rrugëve dytësore. Këtu përkundrazi, është zënë edhe rruga kryesore, është bllokuar. Nuk e di a ke dalë në terren apo jo. Pjerrtësia ishte që të ketë ni shkallë prej 7 shkallë, këtu kie përmi 50 shkallë, nuk e di si është ai projektimi, kush e ka projektue, çfarë inxhinieri apo çfarë punëkryesi, nuk e di kush i kryen këto punime. E disa nga të tjerat, edhe ato të cilat i kanë bërë, janë hapur hendeqet, s'po them 30cm, mos t'i japim shumë kahje tjetër, po ta dish se e kam për qëllim të banorëve, qëllim të qytetarëve. Jeni zotuar se do t'i kryni këto, unë kisha me kërkue ni përgjigje nga të gjitha këto të cilat... unë nuk po i jap edhe të dhënat, bisedat e qytetarëve, të cilët janë të mendimit që në afat, nuk mund na t'i japim afate Komunës, por ata sigurisht e kanë nga revolta, thuhet se nëse në afat prej ni muaji nuk rregullohet, ne do të sjellim edhe mjete të informimit, të shohin në vendin e ngjarjes. Unë nuk jam për me dhonë afate, unë jam për me u rregullue çështja, me atë kontraktorin të ciliët i ka marrë, të merret pak seriozisht, nga e gjithë ajo, edhe kubëzimi, nuk bëhet fjalë këtu për kubëzimin. Në këtë projekt shkruan 1 km, unë vetë kam dalë në vendin e ngjarjes atje, kemi bërë disa nga ato matje aq sa ne dijmë, jo si ekspert, nuk flas në aspektin e ekspertizës, si ekspert, po nuk ke mbi 500 metra rrugë me rërë të shtruar, akoma nuk është në pyetje mo kubëzimi. Ky është ni shqetësim i cili më ka brejtur edhe mu si bashkëfshatar i fshatit Zym, besoj se do të kesh durimin edhe për disa nga të tjerat. Drejtorin e Arsimit m'u duk se e pashë këtu, sigurisht dikush më jep informacion. Kryetar, është marrë autonomia e qeverisjes së buxhetit për shkolla. Je i thirrur me ligjin edhe gjithçka çka flas, flas me ligj, nuk flas me atë, më tha apo dëgjova. Sipas Udhëzimit 33/2011, shkruan se 'çdo shkollë e pranon buxhetin për mallra dhe shërbime, si një shumë fikse, dhe vendos përmes planit të saj buxhetor, se si ta alokojë buxhetin e vet total, në mes të kodeve të ndryshme buxhetore, për mallra dhe shërbime.' A je i njoftuet kryetar ti, se në shkollat tona, pikërisht flas nga ajo shkollë që vij unë, ne nuk kemi letër. Na diktojnë nga Kuvendi Komunal, nga drejtoritë, se çka ne duhet të shpenzojmë. Ne buxhetin duhet ta kemi deri në vitin, para ardhjes së qeverisjes së juaj, secila shkollë, drejtori, ka pasur buxhetin buxhetin e vet të ndarë, dhe atë buxhet në Këshillin

drejtues të shkollës kanë bo furnizimin e shkollave me materiale çfarë kanë nevojë. Bien material të cilët shkolla nuk i hargjon, nuk kemi material të cilët shkolla i hargjon. Kjo ishte ni pikë e cila duhet të na japësh ni sqarim. Ni pikë tjetër në aspektin e fushës nga vij unë, nga arsimit, janë shkarkuar drejtorët nëpër shkolla. Nuk muj ta di sa është sa është ligjore shkarkimi i drejtorëve nëpër shkolla, kur Ministria e Arsimit akoma nuk e ka mbaruar performancën ndaj drejtorëve. Me çfarë ligji bohen shkarkimet, kur nga Ministria e Arsimit nuk janë kthye performancat. Zgjidhen drejtorët e ri, gjithmonë me ligj. Nëse jam gabim, më arsyeton ligji: të ketë të përfunduar me sukses një program kualifikues profesional për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim, të bazuar në standardet e praktikës profesionale për drejtor të shkollave. Cili nga këta drejtorë të cilët ju i keni emëruar i ka këto? E dyta, çka është ma bazike që e qiti në temë diskutimi ni koleg para meje, deklaratën në betim që vërteton se në tri vitet e fundit kandidati/ja nuk ka qenë në asnjë funksion udhëheqës në strukturat e partive politike. Ne këtu Naser Myrtezanin e kemi, e keni emëruar drejtor - veç pak, tani do të flasësh, - a ne këtu e kemi në Kuvend si asambleist. Thuhet se nuk jemi drejtor, ushtrues detyre, çfarë roli ka ushtruesi i detyrës? Vetë je mësues, e dish çka nënshkrujsh, a nënshkruan drejtori i Drejtoratit të Arsimit apo nënshkruan ju. A i menaxhoni ju apo vjen dikush tjetër i menaxhon? Ju kisha lut. Drejtorit të Administratës i kam premtuar në seancën që shkoi, se do ta sjell dokumentin ligjor, që tregon se në Këshillin e prindërve nga DKA-ja nuk ka të drejtë të është z.Faton Nafezi. Ligji numër 06L/114 thotë: Nën puni që emërohet për herë të parë në shërbimin civil, i nënshtrohet një periudhe prove që zgjat për një vit. Marrëdhënia e shërbimit civil për nëpunësit në periudhën prove është marrëdhënie në kusht... gjatë periudhës së provës, bëhet fjalë për atë nëpunës, nëpunësi kryen veprimtaritë e detyrueshme të trajnimit dhe kryen detyrat nën kujdesjen e një nëpunësi. Si do të mund të është ky vlerësues për zgjedhjen e ni drejtorit, kryetar, kur vetë ky është akoma nën monitorim? Në seancë e parë kam deklaruar, nuk kam kundër, por është me ligj kështu. Nuk e vë në dyshim që pas një viti ai do të është aty, nuk e vë absolut në dyshim. Por kohëzgjatja e tij duhet të kalojë mbi ni vit. Derisa ai vetë është nën monitorim, si do të mund ai të bëjë vlerësimin e drejtorëve? Në ni seancë të parë të këtij viti, me urgjencë kemi votuar për ndarjen dhe alokimin e mjeteve për Stadionin e Blaçit. Thajë është shumë urgjente edhe i more të gjithë votat, ishim të ftuem që edhe me kolegë të grupit parlamentar të PDK-së si grup më i madh, të të japim mbështetje se është klub i yni, edhe nuk e diskutojmë atë. Kur kanë me ardhë punimet kryetar, ku janë ato punimet? Sa parë janë hargjue, ku janë alokue, kur do të kryhen ato punime? Thajë është urgjente, unë nuk po shoh urgjencë, punimet janë ndërpre kryetar. Më erdh shumë mirë, pares nuk deshta të kyçem, te kjo pompa e benzinës, nëse arrijmë së bashku ta qesim në emër të Komunes, do ta keni dupllo plus nga unë, do të jem shumë mirënjohës, se ato prona duhet të kthehen qytetarëve të Dragashit, por shumë ma urgjente i kemi ujjat e zeza në Dragash, kryetar. Këto katër-pesë ditët e fundit, si ka filluar pak të përmirësohet moti, ndoshta keni dëgjue se në qendër të Dragashit dëgjohej ni aromë e padurueshme, të bllokimit të ujrave të zeza në qendër të Dragashit. Unë po e shoh se shumë ma urgjente janë këto sesa do urgjente duhet m'i marrë. Nuk flas asnjëherë, ta kam thonë, në aspekt të urrejtjes ose diçka, po gjithçka në të mirë të qytetarëve. Në ni seancë paraprake, nuk po përmendi emër se po lyp debat, po do me dalë këtu në ni minutë replikë, mbrapa Stacionit të Policisë... - po zgjidhe juve ajo që ju konvenon, s'është problem, unë po i paraqes kërkesat e qytetarëve - mbrapa Policisë... mbrapa Policisë, kryetar... Nedžmidin, unë ta kam dëgjue deri tash, me 200 vota na bojsh hallakamë Kuvendin, po m'i pas 5 mijë vota sa të PDK-së e 6 mijë, çka kishe bo? Nuk të kam pengue fare derisa keni folë, ju lutem dëgjo! Të respektoj na masë të jashtëzakonshme, nuk të kam pengue, kështu që

kie durim, nëse durojsh, nëse jo, mund të dalësh jashtë, është punë e jotja. Mbrapa Stacionit të Policisë, kryetar, ka në vit që është shpërthye në gyp, është sanue pak, me sa kam pa, por prapë banorët dhe qytetarët e asaj lagje ngren në çështje problemi, se kur po bjer shi po rriten ujrat dhe ai ujë po hyn edhe brenda. Nuk pate durim, ishte kjo e fundit, kryetar, më fal! Faleminderit!

Uran Halimi: Faleminderit, z.Selaj! Dikush tjetër a do me e marrë fjalën?

Nedžmidin Sejdilar: Kryesues, ju lutem, a jeni ju kryesues a është dikush tjetër kryesues? Ju lutem për qetësi në Kuvend ju jeni. Unë kryesies të kam ty, asnjërin tjetër. Jo, s'mundeni ju! Unë dola me foto, ti qetash...kryesues, a e rregullojsh qetësinë, të lutem, se unë...

Uran Halimi: I nderum, lë le ta kryje fjalën...ta jap fjalën edhe ty qetash. Nedžmidin, a po e losh në ta merre fjalën?

Nedžmidin Sejdilar: Jo, unë jam në rend...

Uran Halimi: A bon le ta kryje replikën edhe mandej ta jap fjalën

Nedžmidin Sejdilar: Zoti Kryetar, po ju kërkoj si kryetar i Kuvendit të më mbronin nga sulme të tilla sa jam në këtë godinë.

Munir Jonuzi: Mendoj se duhet të qetësohemi të gjithë dhe ta lëmë kolegun tonë të na thotë se çfarë mendon. Të gjithë kemi të drejtë të flasim këtu vetëm kur jemi në këtë foltore. Dhe për mirësjellje, ndërsa jemi ulur në kariga, duhet të dëgjojmë. Edhe nëse nuk pajtohemi me atë që na thotë zotri Nedžmidin, është e drejta e tij ta thotë. Ne nuk do t'ia mohojmë një të drejtë të tillë.

Uran Halimi: Të nderuar delegatë, e shpalli këtë seancë të mbyllur. Shihemi në seancën e radhës!